



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 24.04.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimit të projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak dorëheqjeje të gjyqtarit {...}”, duke iu referuar kërkesave të tij të datës 08.01.2019 për dorëheqje nga detyra e gjyqtarit dhe të datës 26.03.2019 për tërheqje nga kërkesa për dorëheqje, përgatitur ky nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

- 10. Erjon Muharremaj* (anëtar)  
*11. Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 5. Marjana Papa, OSCE.*
- 6. Sindi Liço, Qendra Evropiane.*
- 7. Migena Kondo, KSHH.*
- 8. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Erjon Fejzulla, USAID.*
- 11. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 12. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimit të projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak dorëheqjeje të gjyqtarit {...}”, duke iu referuar kërkesave të tij të datës 08.01.2019 për dorëheqje nga detyra e gjyqtarit dhe të datës 26.03.2019 për tërheqje nga kërkesa për dorëheqje, përgatitur ky nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Atëherë, përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 24.04.2019.

Siç jeni vënë në dijeni lidhur me rendin e ditës, sot kemi për shqyrtim 7 çështje në të cilat kërkohet edhe vendimmarrja e KLGJ-së.

Po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, e cila lidhet me deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes të gjyqtarit {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, më datë 28.02.2019.

Në lidhje me këtë pikë, në respektim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare 27.03.2019, me qëllim reflektimin dhe trajtimin edhe të kërkesës së zotit {...} të protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. prot. 1830, datë 26.03.2019, Këshilli ka njoftuar zotin {...} që të parashtojë në seancën plenare kërkesën e tij. Për të vijuar më tej, fjalën po ia lë kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska, lidhur me relatimin e çështjes.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë më herët kemi përgatitur relacionin sa i përket mbarimit të statusit të magjistratit për gjyqtarin {...}, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, referuar kërkesës për dorëheqje së paraqitur nga ana e tij pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 10 janar viti 2019. Në këtë relacion kemi referuar rrethanat e faktit që implikohen lidhur me çështjen e statusit të zotit {...}.

Duhet të bëj një vërejtje sa i përket një rrethane të faktit tek Aneksi A, pika 1, për sa i përket opsionit që ‘brenda datë 17 nëntor 2017 gjyqtari {...} ka plotësuar rregullsisht dhe ka dorëzuar pranë autoriteteve publike përkatëse deklaratën e pasurisë’ - është brenda datës 31 janar të vitit 2018, referuar faktit se, ka pasur një periudhë pezullimi nga Gjykata Kushtetuese.

Ndërkohë, në relacion kemi evidentuar dhe ligjet që implikohen në rastin konkret, duke filluar që nga Kushtetuta dhe më tej Aneksi sa i përket rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, më tej dhe ligji për statusin.

Kemi parashtruar dhe qëndrimet që janë mbajtur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikim dhe Komisioni i Posaçëm i Apelimit në lidhje me çështjen e dorëheqjes së gjyqtarëve që janë subjekt rivlerësimi.

Kemi parashtruar dhe opinionet e dy misionëve që na asistojnë, të USAID-it dhe EURALIUS-it, lidhur me çështjen e dorëheqjes nga detyra të një gjyqtari që është subjekt vlerësimi kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe, në fund kemi parashtruar edhe opinionin sa i përket mbarimit të statusit, në rastin konkret, për gjyqtarin {...}.

Kemi propozuar që Këshilli i Lartë Gjyqësor të deklarojë mbarimin e statusit të gjyqtarit {...} më datë 28 shkurt të vitit 2019.

Në lidhje me këtë propozim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ka vlerësuar se deklarimi i mbarimit të statusit të gjyqtarit për zotin {...} është një detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 65, pika 2 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kësaj dispozite mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit, jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Në rastin konkret, ky afat ligjor tashmë ka kaluar, kjo si rezultat i paqartësisë që ekzistonte për statusin e zotit {...}, ndërsa ai, më datë 10.01.2019 është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërkohë që ligjërisht gëzonte nga ligji të drejtën e ankimit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me vendimin e shkarkimit nga detyra. Nga informacioni i marrë nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit rezulton se zoti {...} ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e tij nga detyra, çka do të thotë se ky vendim, ligjërisht, nuk ka marrë formë të prerë, pra procesi i rivlerësimit për zotin {...} ligjërisht nuk mund të konsiderohet i përfunduar.

Megjithatë kalimi i afatit ligjor si më lartë, për deklarimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për deklarimin e statusit të gjyqtarit për zotin {...}, nuk e vë në pamundësi Këshillin për të bërë një deklaram të tillë për vetë natyrën e këtij vendimi, përveçse mos respektimi i këtij afati, referuar ligjit, nuk mund të çojë në pavlefshmëri të vendimit të Këshillit, për sa kohë ky afat, nuk ka karakter prekluziv por thjesht disiplinues.

Nga ana tjetër, ndërsa zoti {...} në momentin e paraqitjes së dorëheqjes ka qenë në detyrën e gjyqtarit dhe në të njëjtën kohë ai vijon të jetë në proces rivlerësimi kalimtar sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtarë të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht dukjes së interferimit mes këtij procesi me atë të mbarimit të statusit për shkak të dorëheqjes nga detyra, nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për ushtrimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të një detyrimi të tillë ligjor, përveçse nuk ekziston as ndonjë mundësi ligjore që Këshilli i Lartë Gjyqësor të mund të refuzojë deklarimin e mbarimit të statusit të gjyqtarit për zotin {...} për shkak të depozitimit nga ai më datë 10.01.2019 të deklaratës së dorëheqjes nga ko detyrë.

Nëse deklarimi i mbarimit të statusit të gjyqtarit në rastin e zotit {...} apo në çdo rast tjetër të ngjashëm apo krahasimisht të ngjashëm me këtë pas sjellë implikim të caktuar në procesin e rivlerësimit kalimtar sipas aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimi kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kjo është një çështje që përfshihet në fushën e përgjithësisë dhe duhet të trajtohet nga institucionet përkatëse të rivlerësimit kalimtar.

Kemi evidentuar edhe shqetësimin e misionit të EURALIUS dhënë në rastin e opinionit 2 sipas të cilit përdorimi i institutit të dorëheqjes nga detyra të gjyqtarit nga procesi i rivlerësimit kalimtar apo me mos përpalljen e tyre me pasojat që ligji parashikon me rastin e një vendimi të “shkarkimit nga detyra” mund të jetë një indice që mund të konsiderohet nga organi ligjvënës për ndërhyrjen në legjislacion nëse një gjë e tillë është apo duhet të jetë në vullnetin e këtij organi. Por pavarësisht këtij shqetësimi, një rrethanë e tillë nuk legjitimon aspak Këshillin e Lartë Gjyqësor të adoptojë rregulla specifike sa i përket alokimit të institutit të dorëheqjes nga detyra të gjyqtarit apo aq më pak të injorojë aplikimin e këtij instituti në një rast konkret siç është ai i zotit {...}, për sa kohë sikurse Gjykata Kushtetuese ka theksuar “gjyqtari, subjekt i rivlerësimit kalimtar, vijon të jetë në detyrë dhe procesi i rivlerësimit për të nuk ka përfunduar ende”.

Për më tepër, pavarësisht nga vullneti i Këshillit të Lartë Gjyqësor, deklarimi i dorëheqjes nga detyra i gjyqtarit prodhon vetvetiu *ipso lege* efektin e saj juridik pra mbarimin e statusit të gjyqtarit kjo sipas ligjit 65 pika 2 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, referuar të cilit vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit ka vetëm karakter deklarativ dhe jo konstituitiv krijues.

Ndërkohë, mbas përgatitjes së këtij relacioni, referuar deklaratës së dorëheqjes nga detyra të gjyqtarit, zotit {...}, nga ana e tij u paraqit një kërkesë për tërheqjen e deklaratës së dorëheqjes. Edhe për këtë, nga ana e komisionit është përgatitur relacion shtesë sipas kërkesës së Këshillit, por edhe në këtë rast kemi evidentuar pretendimin që janë parashtruar në kërkesës për tërheqjen e kërkesës nga ana e zotit {...}, kemi parashtruar dhe kuadrin ligjor që vlen për trajtim në rastin konkret. Edhe në këtë rast kemi konsideruar se tërheqja e kërkesës së dorëheqjes nga ana e zotit {...} nuk krijon

asnjë pasojë për sa kohë, referuar ligjit, nenit 65/2 të ligjit “Për statusin...”, dorëheqja ka prodhuar efektet nga ligji, pikërisht në datë 28 shkurt, ndërsa tërheqja e kërkesës është bërë mbas këtij momenti, më datë 26 mars 2019.

Gjithsesi konsideruam në mbledhjen e kaluara që gjyqtari zoti {...} të parashtrojë pretendimet e tij në lidhje me deklaratën e dorëheqjes dhe kërkesën për tërheqjen e dorëheqjes, di që është njoftuar. Nëse është prezent, mund të jetë i pranishëm dhe të parashtrojë opinion e tij lidhur me deklaratën e dorëheqjes dhe kërkesën që ka parashtruar për tërheqjen e saj.

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Po ftojme zotin {...} që të jetë këtu në këtë seancë për të dhënë qëndrimin e tij lidhur me çështjen që keni ngritur nga ana e komisionit tuaj.

*(Hyn në sallën e mbledhjes zoti {...}.)*

Përshëndetje, zoti {...}!

Sikurse jeni vënë në dijeni nga administrata, në këtë seancë dëgjimore po diskutohet çështja e statusit tuaj dhe ndaj ka dalë e nevojshme që t’ju thërrasim për të prezantuar para Këshillit qëndrimin që keni ju lidhur me kërkesat e parashtruara Këshillit.

*{...}:* Faleminderit!

Unë i jam nënshtruar procesit të vetingut dhe në datën 8 janar 2019 është bërë seanca dëgjimore. Në atë seancë dëgjimore megjithëse unë kisha bërë relacionin me shkrim në kundërshtim të gjetjeve që kishin bërë gjatë hetimit administrativ...

Më falni, ndoshta është pak gjatë, por do përpiqem maksimalisht t’i bie pak shkurt...

...dhe disa gjëra që ishin krejtësisht të dukshme, pashë që raporti nuk i kishte mënjanuar dhe dukej qartë se ishte një tendencë, të paktën në vlerësimin tim, për shkarkimin tim. Prandaj dhe unë paraqita kërkesën përpara se të merrej vendimi administrativ, në mënyrë që të pezullohej vendimi nga ana e KPK-së dhe të jepja dorëheqjen para jush. Dhe depozitova ankimin përpara se të shpallej vendimi dhe të mbyllej procesi administrativ.

Megjithatë, nga ana e KPK-së nuk u mor parasysh, atëherë unë kërkesën për dorëheqje e dhashë në bazë të aneksit kushtetues të ligjit për vetingun dhe në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pra nuk iu referova ligjit “Për statusin e magjistratit”.

Duke qenë se punët rrodhën ashtu si rrodhën, unë në fakt e ndjeva moralisht si një lloj detyrim që të largohesha nga sistemi jo, me shkarkim. Kjo ishte zgjedhja ime personale, pasi balt u hodh mbi figurën time si gjyqtar, pasi vetëm 3 minuta pasi kishte përfunduar relatori i çështjes relacionin në seancë dëgjimore, në datën 8, domethënë 2 ditë përpara, mediat kishin dhënë që kryetari i Gjykatës së Shkodrës shkarkohet për korrupsion, për lidhje me krimin, etj., etj., dhe vendimin që nxori KPK-ja rreth 1 muaj e gjysmë pastaj nuk u tha më asnjë fjalë nga kjo.

Pra ishte qartë dukshëm një lloj tendence dhe për të mbrojtur një lloj, si të thuash të shpejtojmë çfarë të shpëtojmë, por të paktën moralisht nuk doja që të ikja nga sistemi me shkarkim, pasi unë mendoj se kam punuar me dinjitet, me ndershmëri dhe nuk kisha asnjë shkak për përjashtim, unë dhashë këtë dorëheqje, por kjo nuk u mor parasysh. Përderisa kjo nuk u mor parasysh, unë mendova se kjo si kërkesë ka rënë në dekadencë. Por duke qenë se kërkesa nuk është shqyrtuar nga organi administrativ, pra nga ana juaj, atëherë problemi thjesht bëhet një problem ligjor, rutinë. Ju e kuptoni më mirë se unë besoj, që një kërkesë, në çdo moment, mund të tërhiqet përpara se organi administrativ të jetë shprehur në lidhje me atë kërkesë dhe përderisa nuk ka ndonjë interes publik mendoj unë, atëherë kjo është... ose palët e tjera të interesuara në lidhje me këtë... në fakt unë mendoj se e ka zgjidhur Kodi i Procedurës Administrative, te neni 64 besoj, kur thotë se “...ndryshime apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar”, mendoj unë.

Kjo u bë si të thuash, tërheqja nga dorëheqja, u bë edhe për një fakt të tillë se, edhe vendimi i arsyetuar i cili doli nga KPK-ja lë shumë për të dëshiruar dhe unë e kuptoj se fati im si gjyqtar, në një mënyrë a tjetër ka përfunduar. Nuk jam më gjyqtar në thelb. Jam i pezulluar dhe nuk kam ndonjë shpresë të madhe. Më vjen keq bile, që mund ta them përpara trupës tuaj të nderuar, por ndoshta kjo është detyra juaj më e vështirë, që ju të refuzoni ose të përpiqeni të bllokoni një proces i cili nuk është i drejtë, i ndershëm dhe ligjor. Unë i kam kërkuar edhe organeve të vetingut të zbatohet vetëm ligji për të cilin

nuk ka rëndësi kam qenë apo s'kam qenë unë dakord. Unë jam shkarkuar nga detyra me një motivacion që unë akoma nuk e kam gjetur në asnjë prej vendimeve që ka nxjerrë KPK-ja. Më lejoni që t'ju lexoj. Ndoshta mund të dukem pak jashtë teme, por të lutem:

*“Përfundimisht, -thotë, trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, si dhe vlerësimit tërësorë të çështjes së subjektit të rivlerësimit. Rezulton se ai ka cenuar besimin e publikut.”*

Njëzet e pesë vjet gjyqtar në të njëjtin qytet në Gjykatën e Shkodrës nuk ka pasur asnjë ankesë. KPK-ja nuk ka pasur asnjë ankesë. Sikur të kisha qenë unë prifti apo hoxha i qytetit, për 25 vjet do të isha i sigurt që dikush do të kishte dalë.

Të lutem, më falni, u zgjata, por mendoj se problemi është thjesht ligjor, teknik. Përderisa është një kërkesë e imja, nuk lidhet me interesin publik të cilin e vendosni ju. Unë tërhiqem nga kjo kërkesë.

**Naureda Llagami:** Të falenderoj, zoti {...}!

Fjalën po ia kaloj zotit Toska.

**Ilir Toska:** Do desha t'ju pyesja sepse në kërkesën tuaj për tërheqjen e dorëheqjes referoni se deklaratën e dorëheqjes që keni paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor më datë 10 janar të viti 2019, e keni bërë thjesht për dijeni apo për njoftim, Çfarë keni parasysh me këtë sepse tek teksti nuk ka diçka të tillë formalisht të shkruar.

{...}: Këtu ka ndodhur një keqkuptim.

Unë kur e kam bërë, e kam bërë në dy kopje për t'u paraqitur edhe në KPK edhe për dijeni në KLGJ. Është bërë edhe një tjetër. Meqenëse ato u firmosën, unë aksidentalisht kam paraqitur... Unë me atë tekst në fakt, nuk e mbaj mend që është dorëzuar kjo. U njoha pak me vonesë.

Më falni, kjo mund të jetë shqetësim për punën tuaj se mund të këtë ngjallur ndonjë lloj keqkuptimi, por sinqerisht kjo nuk është bërë me dashje. Përfundimisht, kjo është një çështje ligjore. Nuk mendoj që ne duhet të përpiqemi tani të kapemi 'u tha, s'u



tha'. Ne jemi në këtë pikë. Mua më vjen keq në qoftë se ju jeni shqetësuar, se ndoshta ju kam konsumuar kohë për të bërë këtë seancë. Kjo është, mendoj unë.

**Ilir Toska:** T'ju pyes: -Kur paraqitet deklaratën për dorëheqje nga detyra para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kush ishte vullneti yt, të vazhdonit detyrën apo jo?

{...}: E shpreha. Ndoshta tingëllon pak utopike ose idealiste, por unë nuk kërkoja që të ikja nga sistemi gjyqësor me shkarkim dhe unë jam i bindur se nuk e meritoja këtë gjë. Atë që tregoi pastaj dhe vendimi i arsyetuar i KPK-së. Pra ishte mënyra e vetme të cilën unë mendova të largohem. Më mirë të thonë frikacak se sa të hidhet baltë. T'u thuhet 1000 apo 2000 të burgosurve që janë duke vuajtur burg, që shumica e tyre janë me burgim të përjetshëm, që juve ju ka gjykuar një gjyqtar i korruptuar, i lidhur me krimin, e ku ta di unë. Minimumin të shpëtoja punën e gjyqësorit. Këtë sinqerisht e bëra thjesht... ndoshta është pak idealizëm e s'doja të perceptohesha në këtë situatë ku jetojmë ne sot. Po unë jam nisur vetëm nga kjo. Ky ishte qëllimi im.

**Ilir Toska:** Ju besoni se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është organi kompetent që duhet të trajtojë dorëheqjen nga detyra të gjyqtarit?

{...}: Ajo diskutohet. Ligjet e bëra pak me ngut kanë gjithmonë pak cene. Ajo diskutohet. Ne me Kushtetute u kemi thënë atyre statusin e gjyqtarit.

Një gjykatë, absolutisht për një proces, mendoj unë, që ka kompetenca për atë çështje të cilën gjykon edhe të çdo lloj organi administrativ që mund të jetë në kompetencë të tyre. Kjo është çështje e diskutimit teorik. Ne mund të rrimë me ore të tëra. Mund të ketë juristë që kanë mendime të ndryshme, nga më të ndryshmet. Unë mendoj se po, sepse ajo është rang gjykate, ashtu si Kolegji i Ankimimit është Gjykatë Kushtetuese. Pra unë mendoj kështu.

Megjithatë, minimumi, edhe sikur ata të mos e shikonin veten kompetentë, ata duhet të ndalonin procesin administrativ, ta pezullonin 2 ditë, 5 ditë, edhe të merrej vendimi. Faleminderit!

**Ilir Toska:** Pyetja e fundit që kam është: Ju e keni depozituar deklaratën e dorëheqjen në datë 10 janar. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka marrë vendim po në datë 10 janar, ndërkohë keni bërë tërheqjen e kësaj kërkesë në datë 26 mars. Referuar nenit 65, pika 2 të ligjit të statusit, sipas të cilit "dorëheqja prodhon efekte në fund të

muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes”, mendoni që ka prodhuar efekte deklarata juaj?

{...}: Unë mendoj se nuk ka prodhuar sepse ajo prodhon pasi të marri vendim organi dhe për më tepër që baza ligjore mbi të cilën u bë, u bë duke u nisur nga këto kritere sepse gjyqtari nuk mund ta lërë punën ashtu siç mund ta lërë punën një ministër, pa u shprehur organi kompetent sepse normalisht janë interesat publike ato që pre- valojnë. Unë nuk jam një kopshtar që dhashë dorëheqjen dhe nuk dal në punë dhe punëdhënësi është i detyruar të më ndërpresë rrogën. Unë kështu të paktën e mendoj dhe kjo është fryma e ligjit .. Nëse nuk ka .. nëse mund të këtë interpretime të ndryshme, kjo vjen ose nga pasaktësia se si e shpreh ligjvënësi ose nga mënyra se si arsyetojmë ne mbi atë. Por ama ky është parimi i përgjithshëm. Një gjyqtar nuk mund ta lërë punën pa marrë miratimin e organit epror. Ashtu siç nuk mund ta lërë një ministër, nuk mund ta lërë Guvernatori i Bankës, Shefi i Shtabit të Ushtrisë. Janë poste të cilat janë në hierarki të lartë shtetërore dhe normalisht personat të cilët fitojnë këto poste kanë besueshmëri të lartë dhe kanë një lloj devocioni shoqëror dhe shtetëror më tepër se sa një njeri i zakonshëm.

**Brikena Ukperaj:** Zoti {...}, në fakt vullneti juaj ka qenë pak i paqartë personalisht për mua sepse ju në të njëjtën ditë me ditën e shpalljes së vendimit keni dhënë dorëheqjen dhe siç e argumentoni, dorëheqjen e kishit nga procesi, por që në fakt, Kushtetuta dhe ligji flasin për dorëheqjen nga detyra. Pas vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, keni ushtruar ankim dhe në përmbajtje të ankimit, të paktën nga materialet që ne kemi, ju kërkoni të ndryshoni vendimin e Komisionit të Pavarur dhe të konfirmoheni në detyrë. Pra ju kërkoni që të ktheheni përsëri në detyrën tuaj funksionale si gjyqtar. Kjo logjikë nuk më qëndron. Në qoftë se ju doni, vullneti juaj ishte që të ndërpritej procesi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të largoheshit me atë ndalimin 15 vjet për të mos ushtruar funksionin, të njëjtin vullnet nuk konfirmohet në ankimin që keni bërë te Komisioni i pavarur. Përkundrazi, ju kërkoni prapë të jeni gjyqtar. Kjo është arsyeja që edhe vullneti juaj për të hequr dorë nga detyra apo jo është i dyshimtë. Kur thoni, unë kam dhënë dorëheqjen, nga kush keni dhënë dorëheqjen? Një fjalë e shkurtër.

{...}: Gjithmonë kur ka mendime të ndryshme, gjithmonë ka dhe arsytetime të ndryshme. Ju thashë dhe më përpara, arsytimi ishte se procesi ishte... Të lutem, të mos ndërhyjmë te procesi, të mos flasim më për procesin sepse jam shumë i indinjuar në lidhje me procesin.

**Brikena Ukperaj:** Lëre procesin. Këtu jemi për diçka tjetër.

{...}: Sepse unë jetoj në një komunitet dhe unë ndryshe jam i shkarkuar dhe ndryshme jam i dorëhequr. Unë nuk e kuptoj pse ju nuk e kuptoni këtë arsytimin tim. Me sinqeritet. Sepse dorëheqja me shkarkimin ka impakt tjetër, jo tek unë e tek ti, jo tek të gjithë njerëzit këtu, por tek publiku ka impakt të madh dhe ajo që është për mua më e rëndësishmja është se unë jetoj në një qytet të madh verior, nuk është metropol, dhe për mua rëndësi më të madhe ka, si i themi ne andej nga Shkodra, erzi (fytyra), mënyra në të cilën jetoj në atë komunitet, se sa detyra ime e gjyqtarit. Unë kam 25 vjet gjyqtar. Në një mënyrë a tjetër unë nuk kam çfarë kërkoj më nga jeta si karrierë dhe unë mendoj që karrierën e kam pasur të suksesshme, të mirë, të rregullt. Jo ndonjë ngritje të madhe në detyrë. Nuk kam bërë kurrë kërkesë për të ardhur as gjyqtar në Tiranë. Dhe pse nuk bëhet një pyetje tjetër , që 25 vjet unë nuk kisha një ankesë zonjë? Një ankesë nuk kisha në KPK. Kam ushtruar detyrat e kryetarit të gjykatës dhe 4 vjet. Në pikun e sulmeve që u bënë gjatë gjithë procesit të vetingut. Thjesht unë e hoqa në mënyrë që KPK të mos bënte atë gafë që bëri, po të flasim kështu. Ata e bënë atë gafë dhe unë tashti ligjërisht do ta ndjek deri në fund. Nuk mund të hedhin balte dhe të përdorin në mënyrë kaq të pamoralshme sulmet ndaj një gjyqtari. Nuk jam duke mbrojtur {...}n, jam duke mbrojtur kryetarin e Gjykatës së Shkodrës. Një gjyqtar që ka punuar 25 vjet në një vend. Kjo është logjika ime.

**Brunilda Kadi:** Ndoshta në thelb është e njëjta pyetje që beri kolegja zoti gjyqtar. Por ndoshta thjesht, se edhe unë, që të marrë një vendim duhet ta kem të qartë. Arsyeja pse u vendos që ju të thirreshit këtu, siç dhe u sqaruar, ishte që për këtë Këshill të bëheshe e qartë vullneti juaj, në atë kohë kur keni bërë dorëheqjen dhe sot që ky Këshill do marri vendimin. Unë do t'i bëjë më radhë pyetjet dhe ndoshta më koncize.

Ju çfarë prisnit ka Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në momentin që paraqitët dorëheqjen para tyre? Pra cila do ishte vendimmarrja e tyre me të cilën ju do ishit dakord?

{...}: Unë prisja pushimin e gjykimit dhe mbarimin e mandatit.

**Brunilda Kadi:** Me penalitetin që për 15 vjet ju nuk...?

{...}: Absolutisht po.

**Brunilda Kadi:** Okej. Nuk u dha ky vendim.

{...}: Unë e kam konsideruar gjykatë atë.

**Brunilda Kadi:** E kuptoj! Të lutem zoti gjyqtar. Që të kuptohemi.

Ju e ankimuat këtë vendim?

{...}: Po!

**Brunilda Kadi:** Për çfarë arsye e keni ankimuar, për themelin apo për arsyen që nuk u shpreh në këtë formë që ju pretenduat dhe që sapo e deklaruat?

{...}: Po bie prapë në përsëritje.

**Brunilda Kadi:** Jo të lutem, ankimi juaj, se nuk e kemi në dispozicion dhe ndoshta s'kemi pse ta kemi. Thjesht...

{...}: Ankimi im është ky, që ka pasur shkelje të rënda të Kushtetutës.

**Brunilda Kadi:** Jo! Të lutem, të lutem.

Ju çfarë kërkoni nga KPA-ja sot? T'ju konfirmojë në detyrë apo t'ju ndërpresë procesin...? T'ju konfirmojë në detyrë sepse në themel vendimi i KPK-së ishte i padrejtë, apo kërkoni që të ndërpritet procesi juaj i rivlerësimit me penalitetin që për 15 vjet mos të ushtroni funksione në sistemin e drejtësisë? Cila është pritshmëria juaj për vendimin e KPA-së? Sepse kjo është shumë e rëndësishme.

{...}: Pritshmëria... Kërkesa imë është konfirmim në detyrë, sepse KPK-ja mua më ka shkarkuar nga detyra në mënyrë...

**Brunilda Kadi:** Okej. Nuk e kërkoni variantin... Pyetja ime e trete ishte.

{...}: A ta mbaroj?

**Brunilda Kadi:** Po jo se e thatë, konfirmimin në detyrë apo jo? A është kjo?

{...}: Mund të ishte pak më e gjatë.

**Brunilda Kadi:** Zoti gjyqtar, se ndoshta ju u shpjeguat dhe ne jemi të qartë për këtë pjesë, për arsyet, motivet, dhe është e gjithë e drejta juaj e botës të thoni që është më mirë një vendim kështu dhe të gjitha ato arsyet që thatë, por tani le të fokusohemi te ajo që ne kemi nevojë për të marrë vendimin.

{...}: Desha të them edhe diçka tjetër.

**Brunilda Kadi:** Pyetja ime e trete - të lutem zoti gjyqtar – është: Ju e dhatë dhe e shpjeguat shumë qartë arsyen pse bëtë dorëheqjen, sepse për ju është më mirë një vendimmarrje pushimi me atë penaltitetin se sa me shkarkim. Kjo arsye sot nuk ekziston më përballë nivelit tjetër, te KPA-ja? Sot nuk e keni më këtë arsye?

{...}: Jo, nuk e kam më këtë arsye.

**Brunilda Kadi:** Nuk e keni me këtë arsye?

{...}: Nuk e kam më këtë arsye sepse KPK e shpalli vendimin në mënyrë krejtësisht të paarsyetuar, domethënë e shpalli të paarsyetuar dhe në seancën dëgjimore timen kanë bërë një raport aq mizerje, saqë të gjitha mediat kanë hedhur baltë pa fund. Tashti, ju më kërkoni mua ta pushoj dhe të mos laj faqet e mia? Do ta ndjek.

**Brunilda Kadi:** Zoti gjyqtar, pyetja ime ishte: Sot ju nuk e keni më vullnetin dhe arsyen e dorëheqjes që bëtë përpara KPK-së? Sot nuk e keni më këtë vullnet?

{...}: Jo nuk e kam.

**Brunilda Kadi:** Jo, nuk e keni më? Këtë doja të qartësoja. Faleminderit!

{...}: Dhe diçka tjetër.

Nuk ka shumë lidhje. Unë mendoj se problemi është ligjor shumë i thjeshtë. Është paraqitur një kërkesë. Nuk është marrë vendim administrativ. E tërhiq kërkesën. Unë nuk e di?!

**Naureda Llagimi:** Faleminderit, zoti {...}!

Kemi ndonjë pyetje tjetër nga anëtarët?

Jo!

Të falënderoj për prezencën tuaj.

(Zoti {...} largohet nga salla e mbledhjes.)

Fjalën e ka zoti Toska për propozimin konkret.

**Ilir Toska:** Ne i qëndrojmë propozimit që kemi bërë për deklarimin e mbarimit të statusit sepse statusi ka mbaruar për shkak të ligjit. Zoti {...}, siç u shpreh, ka qenë shumë i qartë në momentin që ka bërë deklaratën e dorëheqjes sepse siç shpjegoi, e konsideronte nga ana tjetër edhe një efekt tjetër të saj që ishte ndërprerja e procesit të rivlerësimit. Fakti që ai efekt, që zoti {...} e priste, nuk do të thotë që nuk ka pasur vullnetin për të dhënë dorëheqjen, pra për t'u larguar nga sistemi. Ndërkohë, ligjërisht, kjo dorëheqje i ka dhënë efektet. Fakti që parimisht mund ta tërhiqi një kërkesë, siç do subjekt tjetër në çdo procedim administrativ, sot është i pamundur për shkak se i ka prodhuar efektet dorëheqja e tij që më datë 28 shkurt dhe ne jemi në pamundësi të konsiderojmë këtë tërheqje të kërkesës. Ky është mendimi im.

**Naureda Llagami:** Atëherë kalojmë në votim. Po!

**Brikena Ukperaj:** Unë në fakt ndaj mendim ndryshme nga zoti Toska.

Mendoj që në kushtet kur çështja ndodhet pranë Komisionit të Apelit, nuk mund të shprehet Këshilli i Lartë Gjyqësor për çështjen, për mënyrën e mbarimit të statusit sepse do interferonte në vendimmarrjen e tyre. Dhe mendoj që ai është një ligj i posaçëm, i cili ka prioritet zbatimi ndaj ligjit për statusin e gjyqtarit. Aktualisht kemi një vendim shkarkimi i cili është në një procedurë ankimimi pranë Kolegjit të Posaçëm, i cili në thelb është gjykatë, ndryshe nga shkalla e parë dhe aktualisht në një paralelizëm do të thosha që çështja ndodhet në një juridiksion gjyqësor dhe asnjë juridiksion tjetër nuk mund të interferojë në zgjidhjen që do të japi. Nga ana tjetër do sillja edhe një krahasim që vërtet në ligjin për vlerësim kalimtar të gjyqtarëve apo në status nuk kemi të rregulluara të gjitha situatat kur gjyqtarët japin dorëheqjet dhe procesi i vlerësimit vazhdon. Gjykata Kushtetuese ka vendosur 2 kritere, që gjyqtari duhet të jetë në detyrë që të japë dorëheqjen dhe që të mos ketë mbaruar procesi i vlerësimit.

Aktualisht për zotin {...} vërtet procesi i vlerësimit nuk ka mbaruar sepse mbaron me përfundimin e vendimit nga Komisioni i Apelit, por zoti {...} aktualisht nuk është në detyrë. Dorëheqjen e ka dhënë para se të merrte Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendim por në logjikën time, ashtu si kundër ne nuk na ndalon dorëheqja e gjyqtarit të fillojmë ose të vazhdojmë një procedim disiplinor, ashtu dhe në këtë rast dorëheqja e

gjqtarit nuk duhet të ndalojë vazhdimin dhe të interferojë vazhdimin e procesit të vetingut.

Prandaj mendoj që, Këshilli i Larët Gjyqësor të mos shprehet lidhur me statusin e zotit {...} sepse vendimi përfundimtar që do ta vendosë nëse statusi i këtij mbaron me shkarkim apo për shkak të dorëheqjes është Komisioni i Apelimit. E vlerësoj të rëndësishme të mos ndërhyjmë në procedurën e Komisionit të Apelimit në rastin konkret, qoftë dhe për shkak të një precedence që mund të krijohet në vazhdim.

**Naureda Llagami:** Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Po i bie shkurt.

Edhe unë jam pak a shumë në një linjë me atë që sapo tha Brikena dhe thjesht diçka të vogël doja të shtoja. Detyrimi që kemi në për t'u shprehur për dorëheqjen ka të bëjë me efektet, d.m.th. çfarë pasojash juridike ka që mund të jenë të pariparueshme, është vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarit në mënyrë të paligjshme, por ndërkohë, siç u tha dhe nga Brikena, ai aktualisht nuk është duke ushtruar detyrën sepse është i pezulluar për një arsye tjetër. Kështu që, ne nuk e kemi këtë rrezik. E vetmja gjë që do diskutohet më vonë është pagesa e tij që do marrë gjatë kësaj kohe, pagesën që e merr për shkak të ligjit të rivlerësimit gjatë kohës që është i pezulluar. Mbasi të presim vendimin e Komisionit të Apelimit, në varësi të atij, ne mund të vlerësojmë situatën dhe të shprehemi ndoshta dhe për pagesën në qoftë se i ka takuar ta marrë ose duhet ta kthejë ose diçka e tillë. Po që është një situatë e rikuperueshme.

**Brikena Ukperaj:** Shumë e rëndësishme është që duhet të tregohemi të kujdesshëm për të parë më tej se si do t'i ketë mbaruar statusi këtij gjyqtari, nëpërmjet mbarimit të statusit me dorëheqje apo nëpërmjet një shkarkimi dhe mendo që shkarkimi në këtë rast ka prioritet për t'u shqyrtuar nga KPA-ja, nuk ka përfunduar ende. Aq më tepër që gjyqtari kërkon konfirmimin në detyrë. Aq më tepër që deklaron që vullneti im nuk ka qenë i lirë, referuar jurisprudencës të KPA-së, "...nëse vullneti i gjyqtarit nuk është i lirë, nuk merret parasysh për efekt të ndërprerjes". Kështu që për të mos interferuar në procedurat e tyre, mendoj që të mos e shqyrtojmë.

**Naureda Llagami:** Diskutime të tjera, kemi?

**Ilir Toska:** Nuk kuptoj faktin që zoti {...} nuk ka qenë i lirë kur ka dhënë vullnetin. Nuk kuptoj as faktin që ne mundemi të imponojmë një organi tjetër kushtetues se çfarë pune do bëjë ai organi tjetër kushtetues. Ne kemi për të bërë këtë që ligji na ngarkon. Faleminderit!

**Nureda Llagami:** Nëse nuk ka diskutime të tjera? Po!

**Maksim Qoku:** Vetëm diçka. Sepse kjo e imja buron nga fakti që nuk mendoj që dorëheqja është e parevokueshme dhe mesa e kuptova dhe duke lexuar tekstin që ai referuar për tjetër gjë dhe këtë e pranoi, mendoj që ai ka të drejtë të heq dorë. Megjithatë unë kam qenë kundër dhe kam dashur trajtimin që në fillim kur ai bëri dorëheqjen sepse jam me idenë që nuk i dihej pranuar dorëheqja. Bile Këshilli as mos ta merrte në shqyrtim për faktin që unë respektoj momentin e pranimin të asaj trupe dhe hyrjes në procesin e vetingut. Deri në atë moment unë e gjej të arsyetuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ai mund të kishte të drejtën të ushtronte dorëheqjen për efektin e ndërprerjes së vlerësimit. Në momentin që pranoi trupën dhe iu nënshtrua gjyqimit, unë them që atij i ngrinë të gjitha të drejtat sepse është në një proces dhe ky proces vazhdon deri në marrjen formë të prerë të vendimit nga Komisioni i Posaçëm i Apelit. Çka do të thotë, do të ishte e padrejtë, por kam përshtypjen, dhe e tepërt ndërhyrja jonë, për sa unë e shoh që si ligj i posaçëm, dispozitat e ligjit 84 prevalojnë për aspektin e vlerësimit të figurës së gjyqtarit në procesin e vetingut, përkundrajt asaj që duhet të shprehemi neve. Prandaj dhe them që të mos shprehemi, por gjithsesi jam kundër aspektit të pranimin të dorëheqjes. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë për procedurë do vazhdojmë të kalojmë projekt-aktin e propozuar nga komisioni.

**Ilir Toska:** Zoti Qoku kishte propozim që të mos marrim vendim apo jo?

**Maksim Qoku:** Nëse...

**Ilir Toska:** Po pra, nëse ka një propozim të tillë mund ta hedhim në votim, duhet të marrim apo jo vendim, pastaj çfarë vendimi duhet të marrim.



*Naureda Llagami*: Atëherë, hedhim në votim propozimin që bënë kolegët lidhur që të mos shprehem për dorëheqjen e zotit {...}, derisa të shprehet Komisioni i Apelit. Kalojmë në votim.

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Kundër.

*Alban Toro*: Kundër.

*Fatmira Luli*: Kundër.

*Marçela Shehu*: Kundër.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Kundër.

Atëherë u miratua propozimi i bërë nga zoti Qoku që Këshilli të mos shprehet lidhur me dorëheqjen e bërë nga zoti {...}, gjyqtar i shkarkuar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 24.04.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve me short” përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Marjana Papa, OSCE.*
6. *Sindi Liço, Qendra Evropiane.*
7. *Migena Kondo, KSHH.*
8. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Erjon Fejzulla, USAID.*
11. *Valbona Bala (Pajo), /USAID.*
12. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve me short” përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Çështja e dytë e rendit të ditës. Sikur se jeni vënë në dijeni pika e dytë e rendit të ditës lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve ka të bëjë lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedura e ndarjes së çështjeve me short.

Këshilli për Emërimet në Drejtësi ka paraqitur një kërkesë për të cilën për shkak të ngarkesës që ka në këtë fazë të funksionimit të saj, kërkon që anëtarët gjyqtarë të këtij komisioni të kenë një ngarkesë më të vogël në veprimtarinë e tyre gjyqësore. Për të na dhënë më shumë informacion lidhur me këtë çështje ia kalojmë fjalën kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zonjës Brikena Ukperaj. Faleminderit, zonja Ukperaj!

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit, Kryetare!

Sikundër dhe ju relatuar, realisht Këshilli i Emërimeve në Drejtësisë, për shkak të detyrave të veta kushtetuese, ka filluar procedurat për verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Nga ana e KED-së janë miratuar aktet e nevojshme nënligjore dhe është proceduar me caktimin e relatorit për çdo pozicion vakant të shpallur.

Në kuadër të ngarkesës së punës e cila vjen dhe rritet për shkak të rregullave të posaçme të parashikuara në ligj por edhe në dy rregulloret, nga ana e Kryetarit të Këshillit të Emërime në Drejtësi është kërkuar KLD-së (KLGJ) që të marrë masat e nevojshme për lehtësimin apo për heqjen e punës së ngarkesës së gjyqtarëve anëtarë të KED-së me qëllim që të kenë angazhimin maksimal në këtë proces kushtetues pranë KED-së, duke marrë parasysh tashmë që kompetencat e relatorit ku secili prej anëtarëve gjyqtar është zgjedhur, janë të tilla që e vënë pothuajse në pamundësi ushtrimin e funksioneve gjyqësore.

Veç kryetarit të Këshillit të Emërime në Drejtësi, janë depozituar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe dy kërkesa individuale të dy gjyqtarëve të gjykatës së apelit, gjyqtarës {...} dhe gjyqtarit {...}. Të dy gjyqtarët kërkojnë mundësinë e përjashtimit nga shorti i çështjeve të reja duke qenë se nuk mund të procedohet me ulje të ngarkesë sipas ligjit për statusin dhe kanë argumentuar pikërisht ngarkesën shumë të madhe të çështjeve që kanë në gjykatë; afatet procedurale të nevojshme që ligji parashikon për gjykimin e çështjeve civile dhe penale dhe njëkohësisht volumin e punës që kanë filluar që pas miratimit të rregullores dhe zgjedhjes së tyre si relatorë kanë filluar që të kenë si anëtarë të KED-së.

Në lidhje me periudhën e përjashtimit, për një prej tyre, është propozuar periudha 2-mujore, ndërkohë një gjyqtar tjetër ka propozuar periudhën 3-mujore, referuar afateve procedurale që parashikohen në ligj dhe në rregullore. Është marrë një informacion paraprak nga ana e Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional lidhur me ngarkesën aktuale që ka çdo gjyqtar. Ka rezultuar që gjyqtari {...} ka një pjesëmarrje në short në masën 100% dhe ka 452 dosje gjyqësore në ngarkim aktualisht. Ndërkohë që gjyqtarja {...} ka edhe ajo pjesëmarrje 100% në short dhe ka një ngarkesë aktuale prej 378 çështjesh në gjykim. Të dy gjyqtarët në kërkesat e tyre janë referuar nenit 25, pika 3

të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe nenit 89 të ligjit “Për organet e qeverisjes”.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës, pasi ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e ka shqyrtuar kërkesën dhe të kryetarit të KED-së dhe të dy gjyqtarëve, në referim të nenit 25, pika 3 të ligjit 98/2016, i cili parashikon mënyrën e ndarjes së çështjeve me short në gjykata dhe parashikon edhe të drejtën e Këshillit për të miratuara rregulla transparente dhe objektive për procedurën e përjashtimit të gjyqtarëve nga shorti për shkak të ngarkesë ose për shkak të angazhimit të gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor. Fakti që ne nuk kemi aktualisht një rregullore të miratuar kjo nuk na ndalon që duke zbatuar drejtpërsëdrejti kriteret ligjore, të trajtojmë kërkesat e gjyqtarëve pikërisht referuar 2 kritereve të vendosura në ligj për përjashtimin nga shorti, që është ngarkesa ose angazhimi i gjyqtarëve në veprimtari të tjera në funksion të gjykatës apo të pushtetit gjyqësor.

Veprimtaria kushtetuese e dy gjyqtarëve anëtarë të KED-së është parë pikërisht në funksion të të dytës, pra të angazhimit të tyre në veprimtari të tjera. Është analizuar volume i punës referuar asaj çfarë parashikon dispozitat ligjore dhe dispozitat e mëtejshme të rregulluara në dy rregulloret e tjera ku volumi i punës së gjyqtarit relator është i konsiderueshëm duke filluar nga mënyra e ndërtimit të korrespondencës me institucionet e tjera, nga procedura e verifikimit, mënyra e relatimit të çështjes, kalimit të relacionit në mbledhje plenare, mandej verifikimi, vlerësimi, pikëzimi, renditja e kandidatëve.

Duke vlerësuar pikërisht këtë volum pune, duke vlerësuar ngarkesën aktuale të gjyqtarëve, si dhe faktin që aktualisht në ligjin procedural, penal dhe civil ka goxha çështje që kërkojnë të gjykohen brenda afateve të posaçme, jo vetëm brenda afatit 14-ditor por ka dhe brenda afateve 15-ditore, 30-ditore, 60-ditore, duke marrë parasysh gjithashtu dhe aktualisht mënyrën se si funksionon sistemi i menaxhimit të çështjeve në mënyrë të tillë që çështjet regjistrohen të gjitha dhe nuk mund të regjistrohen çështje të veçanta, pra që të përjashtosh gjyqtarët nga një kategori e caktuar çështjes, propozojmë që të dy gjyqtarët {...} dhe {...} të përjashtohen për një periudhë 3-mujore nga shqyrtimi i çështjeve në gjykatat e tyre. Referuar periudhës, jemi referuar pikërisht afateve të

vendosura në ligj dhe në rregullore për mënyrën se si procedohet nga gjyqtarët me pritjen e informacionit, dërgimin e shkresave, kryerjen e procedurës së verifikimit, mandej vlerësimin pikëzimin dhe renditjen, duke parashikuar një afat 3-mujor por që realisht duke parë dhe se si ecën procesi i vetingut sepse ky është një proces pothuajse paralel me atë që zhvillohet me vlerësimin kalimtar. Ndoshta do të duhet dhe më tepër kohë. Për të lehtësuar ngarkesën e gjyqtarëve duke marrë parasysh që gjykatat e apelit funksionojnë me trupa gjykues prej tre gjyqtarësh, propozojmë që edhe për këtë periudhë 3-mujore, megjithëse shorti e gjeneron automatikisht këtë propozim, gjyqtarët të përjashtohen edhe nga plotësimi i trupave të tjerë gjykuese, veç trupave të tyre, me përjashtim të rastit kur ky plotësim do të jetë i detyrueshëm, p.sh. mund të ketë raste për ndreqje gabim në material, plotësim sqarim vendimi apo kur gjyqtari është gjyqtar i vetëm me anë të cilit mund të plotësohet trupi tjetër gjykues. Ky është propozimi.

Ndërsa për anëtarët e tjerë të KED-së edhe pse nuk ka një kërkesë individuale prej tyre, shqetësimi i kryetarit të KED-së është marrë në shqyrtim edhe nga ana e Komisionit të Vlerësimit. Nuk mund të behët i njëjti rregullim edhe për kryetarin e komisionit që është dhe anëtar i Gjykatës së Lartë, zoti {...} sepse rregulla të tilla...

Kryetari i KED-së që është dhe anëtar i Gjykatës së Lartë, zoti {...}, për arsye sepse rregulla të tilla do të ndikonin drejtpërdrejt në mënyrën e funksionalitetit të Gjykatës së Lartë referuar numrit të gjyqtarëve që janë aty.

Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative {...} ka një ngarkesë aktuale prej 48 çështjes dhe pjesëmarrja e tij në short është në raportin 50%, çka në vlerësimin tonë nuk ndikon në funksionin e tij si anëtar i KED-së. Ndërsa për anëtarët zëvendësues nuk ka të dhëna për përfshirjen e tyre në cilësinë e relatorit, aq më tepër që ata angazhohen vetëm në rast të pamundësisë apo të konfliktit të interesave të anëtarëve të KED-së.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë sugjerim?

Po!

**Alban Toro:** Atëherë, që në fillim do të them që jam kundër këtij lloj vendimi. Kemi krijuar një standard ku fillimisht kemi krijuar *para kondishën* për të gjithë dhe

rregulla të mirë përcaktuara, pastaj kemi operuar për të miratuar kërkesa të veçanta, të cilat më parë kërkojnë nevojën e rregullimit me rregullore të veçantë.

Ajo që kolegja la pa përmendur është fakti se si do ta ndihmojë procesin mos shortimi i këtyre personave/i gjyqtarëve. Përmendi që ngarkesa aktuale e dy gjyqtarëve është 452 me 313 ndërkohë që mund t'u them, të paktën për Gjykatën e Apelit Tiranë maksimalja është 610 dhe gjyqtari që ka ngarkesën më të paktë është 245, kjo pasi më parë ai ka qenë anëtar i KLD. Kjo për Tiranën.

Për Vlorën, maksimalja është 532 dhe gjyqtari që ka ngarkesën më të vogël është 321. Pra janë shifra që tregojnë që ka një tendencë rritjeje. Dua të shtoj edhe faktin që mesatarisht në javë shtohen me 100 dosje pra 100 gjykime. Aktualisht të 2 gjykatat shqyrtojnë gjykimet e 2016-ës, 2017-ës. Unë nuk e di se si do ta ndihmojë procesin pra ky tremujorësh kur ne po heqim shortin e 3 muajve të 2019 kur ato vazhdojnë të kenë të njëjtën ngarkesë pune. Faktikisht pra po krijojmë një situatë fiktive, po duket sikur po i ndihmojmë, por në fakt po bëjmë të kundërtën, po mbingarkojmë sistemin. Përveç faktit që kemi bërë apele fluturuese për të mirë administruar sistemin e cunguar të drejtësisë, tani shtojmë dhe një ngarkesë fiktive. Pra aktualisht ata gjykojnë 2016-2017. Si do ta ndihmojmë neve me 3 muaj të 2019-ës?

**Brikena Ukperaj:** Të sqaroj edhe një herë. Qëllimi...

**Alban Toro:** Edhe një të fundit.

**Naureda Llagami:** Sa ta mbaroj zoti Toro, të lutem!

**Alban Toro:** Do më bënte sens nëse neve do t'i hiqim nga shorti i çështjeve të cilat kanë, për efekt të ligjit procedural kanë afate të caktuara dhe të shpejta për të cilat ato krijojnë një ngarkesë, normal që edhe duhet të përjashtohen nga këto lloj shortesh. Por për t'i hequr nga shorti i 2019-ës, ndërkohë që gjykohet 2016-2017, nuk më duket mirë administrim i sistemit.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, për të dhënë përgjigje.

Unë e kuptoj që përjashtimi i dy gjyqtarëve në kushtet aktuale si është sistemi, vështirëson procesin e funksionimit të gjykatave. Por qëllimi i kësaj nuk është për të ndihmuar gjykatat, është për të ndihmuar një organ kushtetues që duhet të zgjedhë brenda një afati sepse jemi pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Inspektor të Lartë të Drejtësisë, dhe

qëllimi është për t'u krijuar këtyre gjyqtarëve lehtësi në punën e tyre që t'i përkushtohen për këtë periudhë 3-mujore pikërisht këtij procesi, ku në cilësinë e relatorit, volumi i punës, referuar rregulloreve - besoj se janë të njohura edhe për ne rregulloret sepse mbi ato po punojmë - është voluminoz.

Tani këta tre gjyqtarë nuk është se nuk do të gjykojnë. Ato çështje të mbartura të 2016-2017 që i kanë, do t'i marrin. Nuk do të marrin çështje të reja. Është parë si opsion nëse mund të bëhet një kategori çështjes që të përjashtoheshin, por sistemet elektronike të gjykatave nuk... Sot është sistem elektronik. Të gjitha çështjet regjistrohen dhe hidhen dhe nuk e ndan dot sekretaria nëse ky vendim i ndërmjetëm duhet të gjykohet brenda 30 ditëve në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, apo do të kalojë në seancë gjyqësore apo do ndjekë radhën e shqyrtimit të çështjes. Kjo është e gjitha.

**Alban Toro:** Kalendari i çështjeve është 2016-2017. Ne po heqim 2019. Ku krijohen efektet? S'ka efekte. S'ka efekte.

Unë kam 2016-ën në dorë. Do i them mos merr 2019-ën. Ai ka 2016-ën.

**Brunilda Kadi:** E kuptoj Alban. Por shorti që hidhet tani mund të ketë kërkesa emergjente që të shqyrtohen. Atë që po thotë Brikena.

**Alban Toro:** Dakord. Por të specifikohet, që të kufizojmë.

**Brunilda Kadi:** Po nuk e ndan dot sistemi atë.

**Alban Toro:** Tani ç'të them unë?! Të bëjmë një sistem që ta ndajë.

**Brunilda Kadi:** Po mirë, se tre muaj është koha. Nuk ndikon as negativisht tek gjykata, dhe ndërkohë ne bëjmë atë që kemi mundësi, për të ndihmuar procesin.

**Alban Toro:** 100 dosje në javë, nuk ndikon tek gjykata?!

Heq dy persona... se ca edhe sëmuren. E kanë sistematike.

**Brunilda Kadi:** E kuptoj. Por duke peshuar prioritetet, kjo ndoshta është më e rëndësishme kjo pjesa tjetër sepse... Okej, bën sens ajo që thoni juve, që nuk ndikon, por është puna që ju e dini që me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile ka kërkesa shumë emergjente që ata janë të detyruar...

*(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Të kuptoj shumë mirë por nuk besoj se...



**Naureda Llagami:** Diskutim tjetër lidhur me projektvendimin e propozuar nga Komisioni?

Jo!

**Fatmira Luli:** A të bëj unë një propozim?

Të lëmë vetëm pikën 2, përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...} nga procedurat e plotësimit të trupave të tjerë gjykues, meqenëse vërtet ky është efekti. Në rastin e parë ato nuk krijojnë asnjë ndikim në lehtësimin e çështjeve që po gjykojnë. Kjo pika e dytë mund të krijojë lehtësim në gjykim. Të mos marrin pjesë as në transferim...

**Naureda Llagami:** Atëherë, do kalojmë në votim projekt-aktin e propozuar nga Komisioni dhe më pas propozimi nga anëtari i Këshillit. Dakord?

Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës. Të lutem!

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Pro

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi projektvendimin sipas propozimit që ka bërë Komisioni përkatës.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 24.04.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Marjana Papa, OSCE.*
6. *Sindi Liço, Qendra Evropiane.*
7. *Migena Kondo, KSHH.*
8. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Erjon Fejzulla, USAID.*
11. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
12. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me ngritjen e Komisionit të përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Larët të Drejtësisë të përbërë nga tre anëtarë, dy anëtarë jo gjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar. Lidhur me propozimin përkatës, dëshiroj t’ju sqaroj se:

Sikurse jeni në dijeni, me reformën në drejtësi dhe gjithë kuadrin ligjor, ndryshimet në ligjet e reformës së drejtësisë ka parashikuar që të krijohen institucione të reja të sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu edhe ish-Këshillin e Larët të Drejtësisë ashtu si dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Krijimi i KLGJ-së më datë 12 dhjetor 2018, solli si pasojë ndalimin e funksionimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, administrata e të cilit transferohet pranë KLGJ-së. Ndërkohë që ligji ka parashikuar që disa inspektorë janë pjesë e KLGJ-së

së sapo-krijuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) nuk është krijuar ende dhe disa prej inspektorëve të Inspektoratit të mëparshëm nuk mund të transferohen tek ky institucion (siç edhe parashikon Kushtetuta dhe ligjet e reformës), ndaj kërkohet që KLGJ, të japë një zgjidhje lidhur me këtë situatë.

Ky shqetësim është diskutuar nga KLGJ-ja, menjëherë me krijimin e këtij institucioni, dhe konkretisht, në mbledhjen e tij të datës 21 dhjetor 2018, ku ndër të tjera u vlerësua që të kërkohet edhe një mendim i misionit të EURALIUS dhe USAID lidhur me statusin ligjor të kësaj strukture, si dhe për të rekomanduar opsione dhe zgjidhjet për situatën ligjore të krijuar.

Misioni EURALIUS nga ana e tij, ka dërguar pranë Këshillit një dokument të emërtuar “Pozicioni i përkohshëm i inspektorëve pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, në të cilën është analizuar situata e krijuar lidhur me funksionimin e Inspektoratit, pas mbylljes së ish-KLD-së dhe krijimit të KLGJ-së, ndërkohë që zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk është krijuar ende, -sikurse rezulton akoma.

Dokumenti ka vlerësuar dhe ka mbajtur në konsideratë, në të gjithë analizën e tij, kuadrin ligjor në fuqi, duke filluar nga Kushtetuta, nenet respektive 147/d, 179, pika 9, ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 283, ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, i datës 10.04.2017, ku ndër të tjera arsyetohet se: “...Fryma që përshkon Kushtetutën edhe pas ndryshimeve kushtetuese, është vijimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve për të garantuar vlerat dhe parimet, të cilat krijojnë bazën e shtetit të së drejtës”.

Dokumenti i ka dhënë përgjigje edhe disa pyetjeve të ngritura, lidhur me (i) organin që ka përgjegjësinë për të vendosur për statusin e inspektorëve të Inspektoratit të ish-KLD-së; (ii) statusin e inspektorëve që kanë punuar me vlerësimin profesional të gjyqtarëve, dhe me hetimin disiplinor të tyre, (iii) nëse Kryeinspektori dhe inspektorët, magjistratë, që janë marrë me hetimin disiplinor do të konsiderohen përkohësisht pjesë e KLGJ-së, periudhën që mund të zgjasë ky transferim, dhe kompetencat që mund të ushtrojë përgjatë kësaj periudhe; (iv) shqyrtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor gjatë periudhës kalimtare.

Dokumenti i prezantuar nga EURALIUS ka theksuar se KLGJ do të duhet të vlerësojë faktet dhe të përcaktojë rast pas rasti nëse një inspektor individual ka punuar kryesisht për vlerësimin profesional ose kryesisht për hetimin disiplinore, duke marrë në konsideratë se ligji “Për statusin” e ndërton vlerësimin e aftësisë si pjesë të vlerësimit profesional. Për Kryeinspektorin, ligji ka parashikuar qartë transferimin tek ILD, sapo të krijohet. Këshilli mund të analizojë me kujdes të dhënat e dosjeve personale për secilin ish-inspektor dhe mbështetur në këtë gjë, të përcaktojë qartë se kush ka statusin e magjistratit dhe kush nuk e ka statusin e magjistratit.

Lidhur me inspektorët të cilët janë caktuar dhe kanë ushtruar detyra për vlerësimin e performancës ata duhet të transferohen në KLGJ, ndërkohë që për magjistratët që kanë ushtruar detyrën, fokusuar në hetimin disiplinore ndaj gjyqtarëve, dokumenti propozon që t’i ofrohet një zgjidhje e posaçme duke mbetur pjesë e KLGJ-së deri në krijimin e ILD-së. Në çdo rast, një transferim i tillë duhet të konsiderohet si një transferim i përkohshëm. Përgjatë kësaj periudhe tranzitore, këta inspektorë, mund të vazhdojnë funksionet e tyre, pasi siç duket, theksohet në dokument, synimi ligjvënësit ka qenë vazhdimësia e institucioneve.

Lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor, dokumenti thekson se kjo detyrë, i përket ILD-së, ashtu si dhe mund të ketë opsion që Kryeinspektorët dhe inspektorët magjistratë, të vijojë të bëjë shqyrtimin e këtyre ankesave të cilat menjëherë kalojnë pranë ILD-së në momentin e krijimit, ashtu si dhe të kuadër të vazhdimësisë së funksionimit të institucioneve, nëpërmjet një ndarje të funksioneve midis KLGJ-së dhe një strukture të veçantë që përfshin kryeinspektoratin. Ndërkohë një opsion tjetër, është që KLGJ nuk ka ndonjë funksion lidhur me hetimin disiplinor, dhe aktualisht nuk ekziston asnjë institucion kompetent në këtë drejtim, pasi kompetente është vetëm ILD.

Duke vlerësuar situatën e funksionimit të inspektorëve të ish-KLD-së si mjaft të rëndësishme, sidomos në kushtet e miratimit dhe ngritjes së strukturës së re organizative të administratës së KLGJ-së, propozohet krijimi i një Komisioni të përkohshëm për analizimin e të dhënave dhe përcaktimin e statusit individual dhe karrierës së inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në nenin 62, pika 12 e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Komisioni propozohet të përbëhet nga

tre anëtarë, dy anëtarë jo gjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar, ndërkohë mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të përkohshëm propozohet të jetë sipas procedurës së zakonshme të krijuar nga këshilli në rastet e përbërjes së komisioneve, pra nëpërmjet përzgjedhjes me short të secilit anëtar. Në këtë short, pjesëmarrës në përzgjedhjen e anëtarit jo gjyqtar do marrin pjesë 4 anëtarë, përjashtuar Kryetaren e Këshillit, ndërkohë në përzgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë do të marrin pjesë 6 anëtarë gjyqtarë.

Ky Komisioni i përkohshëm përgjatë punës së tij, duhet të shqyrtojë dosjet personale të Kryeinspektorit dhe të secilit inspektor, duke evidentuar të dhënat individuale të tyre, dhe bazuar në këto të dhëna, në historikun profesional harton një raport për Këshillin, i cili duhet të përmbajë sa më poshtë: a) Inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësive lidhur me vlerësimin profesional dhe etik të gjyqtarëve; b) Inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësive lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve; c) Inspektorët të cilët gëzojnë statusin e magjistratit dhe cilët ndër inspektorë nuk e gëzojnë këtë status; d) Inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t'u emëruar gjyqtar në gjykatën e apelit; e) Inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar jo më pak se 5 vjet.

Gjithashtu vlerësohet e vlefshme për këtë proces, që Komisioni të reflektojë në raportin e tij pëlqimin ose jo, të secilit inspektor, për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë pranë KLGJ-së, deri në krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ashtu si dhe çdo e dhënë, e cila kontribuon në përmbushjen e qëllimit për të cilin do të ngrihet ky Komision i përkohshëm.

Vlerësohet që afati i ushtrimit të veprimtarisë të këtij Komisioni të jetë për një periudhë dy javore, kohë e mjaftueshme për të analizuar të dhënat dhe për të hartuar raportin për Këshillin.

Ky është propozimi lidhur me ngritjen e Komisionit të përkohshëm.

Kemi ndonjë? Po!

**Alban Toro:** Thjesht një tërheqje vëmendje nëse është e mundur, ky afati 2 javor... brenda 2 javëve nga ngritja e Komisionit depoziton pranë Këshillit raportin. Duke pasur parasysh ngarkesën e gjithsecilit në Këshill, besoj që ky afat është shumë i ngushtë. E dyta është që tek pika e pestë, nuk e kuptoj, duhet të këtë dhe anëtarë të komisionit dhe jo anëtarë të komisionit? Anëtarë komisioni dhe anëtarë jo të komisionit. Anëtarët jo të komisionit kush janë?

**Erjon Muharremaj:** Anëtarë gjyqtarë dhe jo gjyqtarë.

**Alban Toro:** Këtu është anëtar komisioni.

**Naureda Llagami:** Faleminderit shumë për sugjerimin.

Administrata do ta reflektoj direkt. Ju falenderoj!

Lidhur me afatin dyjavor, mund të jap përgjigje dhe pastaj e diskutojmë dhe mund ta hedhim për votim? Po!

**Marçela Shehu:** Po për afatin dyjavore që është parashikuar, duke qenë se ju sollët në vëmendje dhe propozimin e misionit EURALIUS, pikërisht në propozimin që ka bërë ky mision parashikohet që KLGJ duhet t'i drejtohet për problematika që lidhen me statusin e tyre edhe Komisionit të Venecias nëse do ta çmojë dhe nëse ne do parashikojmë një afat 2-javor, kam përshtypjen që këtë sugjerim që na është bërë nga misioni EURALIUS nuk do jemi në mundësi për ta realizuar. Kështu që, nëse nuk ka një afat të caktuar nga ligji për përgatitjen e këtyre raporteve, unë sugjeroj që ky afat të ishte më i gjatë. Edhe për t'i dhënë kohë anëtarëve që të punojnë dhe t'i vlerësojnë siç duhet dosjet por edhe për të evidentuar rast pas rasti nëse ka vend për t'u drejtuar apo jo Komisionit të Venecias.

**Brunilda Kadi:** Mendoj që ajo pika e pestë nuk është gabim sepse sqarohet më poshtë. Domethënë, është e ndarë pika e pestë në "a" dhe "b". Kur zgjidhen jo gjyqtarët dhe kur zgjidhen gjyqtarët. Kur të rrihet te shorti, thuhet je anëtar ose nuk do jesh anëtar. Kështu që kam përshtypjen që nuk është gabim pika 5. Nuk është gabim, jo.

Po pra është e përgjithshme, por pastaj shorti ndahet në pikën "a" dhe në pikën "b". Hidhen më vete gjyqtarët dhe më vete jo gjyqtarët. Ti kur tërheq shirit, je anëtar komisioni ose jo anëtar komisioni.

**Naureda Llagami:** Atëherë. Lidhur me merakun që kemi për afatin.



Faleminderit për sugjerimin. Administrata do ta çekojë dhe ta shikojë nëse është formulim i duhur apo jo.

Për sa i përket afatit dëshiroj t'ju sjell në vëmendje që, lidhur me çështjen e Komisionit të Venecias ka qene një situatë në të cilën, e para, situata ka qenë para 4 muajsh dhe e dyta, në Komisionin e Venecias do të ngrihen shumë çështje, për të cilat neve, ato shumë çështje që do të ngrihen, do të jetë një pjesë tjetër ndoshta e vendimmarrjes, nëse ju e gjykoni dhe le të vijë propozimi nga Komisioni i Karrierës, nëse ju e gjykoni që t'i çojmë për çështjen për në Venecia. Atë që unë gjykoj në cilësinë e Kryetares së KLGJ-së është pjesa e strukturës. Siç jeni vënë në dijeni në mbledhjen e fundit të qeverisë na është miratuar struktura ose më mirë është miratuar pagat referuese lidhur me strukturën dhe, në situatën shumë imediate ne duhet të bëjmë ristrukturimin e institucionit dhe është shumë e nevojshme që në fazën e ristrukturimit ka disa vendimmarrje që kanë efekte financiare që lidhet dhe me pagën që gëzojnë sot inspektorët, që kjo ka të bëjë me statusin e tyre.

Për këtë çështje unë kërkoj që Komisioni të reagojë shumë shpejt sepse efektet financiare mund të jenë më pas që neve të sanksionoheni për faktin që mund të kemi dhënë paga të cilat nuk janë në qasje me statusin e tyre. Kështu që në këtë lloj fryme, afati 2-javor është më se racional, për të vlerësuar nëse kanë statusin magjistrat apo nëse nuk e kanë statusin e magjistratit sepse ka të bëjë me pagën që do përfitojnë ato dhe, nëse ato duan të jenë pjesë e strukturës tonë apo nëse nuk duan të jenë pjesë e strukturës tonë. Lidhur me çështjen e Komisionit të Venecias unë mirëpres nga Komisioni përkatës që është për këtë çështje, të më bëjë propozimet. Jam shumë e hapur ta fus në rend dite dhe t'ia çojmë pyetjet Komisionit të Venecias. Ky lloj Komisioni është vetëm për statusin për të vlerësuar dhe që impakti kryesor është impakti financiar.

Ndonjë diskutim tjetër?

**Dritan Hallunaj:** Po, unë jam plotësisht dakord me këtë, por dua që të futet si... nuk e di nëse do bëhet ndryshimi tek ky projektvendimi apo do ta përpilojmë ne, për sa i përket pjesëmarrjes së anëtarëve në këtë Komision, pasi, flas për veten time, duke qenë se ndodhem në tre komisione, unë çmoj që ato që janë anëtarë apo kryetarë të komisioneve, të përjashtohen nga kjo, që të kemi një baraspeshim të punës dhe një ndarje. Them edhe

njëherë, duke qenë kryetar tek një komision, dhe dy të tjerë si anëtar, po e shoh që po na ngarkohet puna përditë e më tepër, gjithashtu duke përfshirë këtu dhe pjesën e ndihmësve, pra, nuk i kemi ndihmësit, dhe unë propozoj që shorti, për sa i përket anëtarëve gjyqtarë dhe jo gjyqtarë, të marrin pjesë vetëm ato që nuk janë kryetarë të komisioneve.

**Naureda Llagami:** Kjo çështje është për procedurë, nëse ne do t'i përjashtojmë apo jo kryetarët e komisioneve përkatëse në hedhjen e shortit. Po!

**Marçela Shehu:** Atëherë, me aq sa kuptova nga fjala juaj, ky komision duhet të ngrihet dhe duhet të shprehet për një afat 2-javor dhe nëse dikush apo komisioni vlerëson se duhet t'i drejtohet Komisionit të Venecias, atëherë ky është një moment tjetër. Këtë kuptova nga fjala juaj. Dhe nëse Komisioni i Venecias do të na japë një mendim ndryshe, atëherë në do të rishikojmë vendimin që ne do të marrim për statusin. Ky është mendimi juaj? Okej!

Lidhur me propozimin e Tanit, për të përjashtuar kryetarët e komisioneve të përhershme, unë nuk jam dakord. Të gjitha projekt-aktet, relacionet, përgatiten nga komisioni, nuk përgatiten vetëm nga kryetarët. Nëse dikush do të propozojë që të vetë përjashtohet sepse është shumë i ngarkuar, atëherë kjo të bëhet në mënyrë nominale për secilin nga ata, por nuk ka pse të ketë një rregull ku të përjashtohen kryetarët e komisioneve për shkak të ngarkesës. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Tjetër kemi?

Atëherë, unë sugjeroj që kjo çështje, përpara se të kalojmë projekt-aktin, do doja që të hidhja në votim, lidhur me përjashtimin e kryetarëve të komisioneve.

**Brunilda Kadi:** Një sekondë, të lutem.

Atëherë në qoftë se hidhet në votim, kjo është në kundërshtim me ligjin, sepse ligji thotë hidhet me short, dhe në qoftë se e votoni këtë, s'ka më short pastaj.

**Naureda Llagami:** Jo, jo, një sekondë.

Nuk po hedhim... Shorti do të vazhdojë.

**Brunilda Kadi:** Po midis kujt do të hidhet shorti pastaj?

Sepse janë të gjithë kryetarë. Kryetare nuk jam unë dhe Marçela. Për kë do ta hidhni shortin pastaj? Çfarë po bëni? Shaka po bëni?

**Dritan Hallunaj:** Prapë short është.

**Brunilda Kadi:** Po kush e mati njëherë, cili ka punë më shumë e kush ka më pak? Po mirë është që, ajo që thuhet të ketë dhe një lloj arsyesimi tani.

**Naureda Llagami:** Hajde e votojmë, nëse nuk ashtu, e kalojmë.

**Brunilda Kadi:** Po jo, se po të bëhen votat andej nga janë kryetarët, nuk ka kuptim arsyesimi. Se të ketë dhe një lloj sensi ajo që diskutohet. Nuk e di kush këtu merr përsipër, ka kompetencën, të përcaktojë se cili nga ne punon më shumë dhe paska ngarkesë? Këtë nuk e kuptoj unë në gjithë këtë procedurë?!

**Dritan Hallunaj:** Atëherë, nuk marrë përsipër që të them që unë punoj më shumë apo tjetri punon më shumë a më pak. Themi të bëjmë një shpërndarje. Duke thënë të bëjmë një shpërndarje është më mirë që gjithsecili të ketë atë dhe pastaj as nuk tha njeri që unë punoj shumë, apo punon tjetri pak apo...

**Marçela Shehu:** Jo, kam unë një propozim. Nëse njëri nga kryetarët i bie shorti që të jetë anëtar i këtij komisioni, unë i propozoj Kryetares që mos ta propozojë si kryetar të atij komisioni, që të bëhet shpërndarja e punës.

**Brikena Ukperaj:** Në fakt, ligji parashikon që, në momentin kur Këshilli qoftë ngre komisionet e përhershme, qoftë nge komisione të përkohshme, duhet të bëjë një shpërndarje të barabartë të punës. Aktualisht shorti, për mendimin tim, parashikohet vetëm në rastin kur është Komisioni që shqyrton ankesat ndaj vendimeve të Inspektoratit, nuk parashikon short ligji, në qoftë se i referohemi ligjit.

Tani, për të patur një ngarkesë të barabartë të punës, shpërndarja në komisione, qoftë në të përhershme, qoftë në të përkohshme, nuk ka qenë e njëjtë. Nuk them sot që njëri punon më shumë apo njëri më pak, por unë jam me idenë që shpërndarja nëpër komisione të jetë e njëjtë për të gjithë ne. Në qoftë se vazhdojmë me short, shorti mund të ndodhë që njëri nga ne të jetë në 4 komisione. Nuk matet ngarkesa me sa punë që bën, sepse nuk e matim dot. Një komision mund të ketë shumë punë. Iliri punon gjithë ditën bashkë me dy kolegët e Komisionit të Karrierës. Ndërkohë që një komision tjetër, ndoshta për shkak të kompetencave nuk ka produkte. Por, kjo nuk do të thotë që punojnë. Ngarkesën ta matim me pjesëmarrjen të secilit nga ne në komisione, për të patur një shpërndarje të barabartë të ngarkesës. Ky është propozimi im.

**Marçela Shehu:** Dhe që të kishim këtë shpërndarje të drejtë të ngarkesës, ne duhet të kishim një rregullore se si duhet të funksiononte Këshilli, si të ndaheshin Komisionet dhe si të ndaheshin kompetencat dhe si të ndahej puna.

**Naureda Llagami:** Për të qenë konkret. Kalojmë propozimin e zotit Hallunaj njëherë dhe më pas kalojmë propozimin e zonjës Ukperaj. Dakord?

Atëherë, sipas propozimin... Ah, ke zoti Qoku? Po!

**Maksim Qoku:** Kam një të fundit dhe vëmë çatinë.

Unë e thashë edhe në atë mbledhjen jo formale. Do tregohemi jo të drejtë dhe jo racional, po hymë të ndajmë punon njëri e punon tjetri sepse ka një gjë, shorti e di ç'është? Është thjesht një fat, që të paktën ne s'e kemi më me vete, se e zgjodhëm, por ne po punojmë në komisione dhe e dimë që nuk kemi vënë që t'i bëjë ky apo t'i bëjë ky. Ne kemi mbajtur atë balancën që, -e bëj unë këtë; -e bëj unë këtë. Për këtë ne s'kemi edhe orar. Në qoftë se ka qenë nevoja të dalë, të dalë. Unë e di për shembull si i disiplinës, që ne jemi të mangët në atë që jemi, dhe kam marrë Shqipërinë, dhe kam marrë atë tjetrën. Pra, ne e kemi në ndërgjegje atë dhe mos t'i hyjmë kësaj. Jo që kush punon më shumë se është e turpshme, por dhe të jetë ky, të përjashtohet ky, se do bëjmë një disbalancë pastaj, do mbajmë inat me njëri-tjetrin.

Për mua edhe e bëjmë këtë votim por më duket i tepërt, s'ka kuptim. S'jemi dhe kalamaj. E bëjmë shortin në aspektin e fatit dhe jam me logjikën e Marçelës që, ai që dihet që është vërtet i ngarkuar, normalisht që në atë trup do jetë jo aq i angazhuar sa mbase ne të tjerët. Por ne orar s'po vëmë. Por edhe po të jetë nevoja, do dalim mbas dite. Kështu që.

**Naureda Llagami:** Në fakt, për të sqaruar në fakt situatat. Unë kam tentuar të bëj edhe logjikën e Marçelës, por po nga ju, kur unë kam propozuar një kryetar, duke menduar edhe shpërndarjen, po nga ju është vendosur refuzimi për të pranuar kryetarin. Pra, atë që lexoj unë nga anëtarët është që kur vjen puna tek përgjegjësitë dhe kur vjen puna tek marrja e detyrimeve, të gjithë mundohemi që ndoshta edhe mos t'i marrim edhe aq me zell të madh. Për këtë arsye shorti është pjesa që unë e kam kuptuar që me sa duket kjo KLGJ do funksionojë vetëm nëpërmjet shortit, përmes goglave. Do vazhdojmë me goglat. Kriteri racional që mund të propozohet nga ju është votim prapë nga ju. Nëse

ngrihet një anëtar dhe më thotë që unë dua ta përdorësh këtë kriter, unë do ta hedh në votim, siç hedhim në votim shumë gjëra të tjera, për gjëra që ne i dimë shumë mirë dhe prapë i hedhim në votim. Kështu që, tek kjo pjesë nuk kam parë nga ju asnjë fleksibilitet tek pjesa që të mirëkuptohemi. Ju kam tentuar në diskutime informale dhe asnjëri nga ju nuk ka thënë, -okej, më vë mua këtu, se do ta bëj këtë gjë. Të gjithë dimë të diskutojmë çfarë bën tjetri, por asnjë nuk merr përgjegjësi se çfarë bën ai.

Kështu që në këtë frymë..

**Marçela Shehu:** Më fal, se unë nuk e di kur është bërë ky diskutimi informal dhe me kë? Me kë është bërë ky diskutimi informal, që kush do bëhet kryetar i këtij komisioni ose jo. Domethënë ajo është bërë gjithmonë. Komisionet janë zgjedhur gjithmonë në mbledhjet plenare. Kryetarët janë zgjedhur sipas procedurave, bazuar në propozimin tuaj, ka vendosur komisioni.

*(Kryetarja flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Naureda Llagami:** Dhe e keni refuzuar propozimin.

**Marçela Shehu:** Kush i ka refuzuar?

**Naureda Llagami:** Po, kam pasur raste që më janë refuzuar.

Kush dhe ku janë realizuar këto takime informale, se unë nuk e di?!

*(Kryetarja flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Naureda Llagami:** Jo më larg se dje e diskutuam dhe s'pranuam.

A e diskutuam dje për këtë?

**Marçela Shehu:** Komisioni krijohet në mbledhje. Vendimi merret në mbledhje, këtu krijohet komisioni, këtu merret vendimi.

**Naureda Llagami:** Shumë bukur, meqë vendimi merret në mbledhje, kalojmë në votim propozimin e bërë nga zoti Hallunaj, lidhur me përjashtimin nga shorti të kryetarëve të komisioneve. Kalojmë në votim.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Kalojmë tek projekt-akti sipas propozimit të bërë nga Kryetarja.

**Brunilda Kadi:** Një sekondë, thjesht për procedurë.

Kam përshtypjen që votimi u hodh gabim se ne nuk diskutuam do ta krijojmë njëherë këtë komision, pastaj që të kishim hyrë në detaje, se siç edhe u kapërcye edhe rendi i ditës që s'u hodh fare në votim. Kështu që, ndoshta pa kuptim. Por a mund të diskutojmë tani, duhet ngritur apo s'duhet ngritur ky komisioni, si, qysh e tek. Por meqë u kapërcye, ndoshta edhe u parashkrua.

**Naureda Llagami:** Sikur e mbaruam këtë diskutim sepse unë mbasi mbarova diskutimin, prezantimin, mori zoti Toro fjalën. Bëri diskutimet e veta. More fjalën.. Okej? Në qoftë se ti ke diskutime të tjera, kësaj i thonë të rrimë me kalvarin e gjatë të diskutimeve, kur i kemi ezauruar.

Kalojmë në votim të projekt-aktit, sipas propozimit të bërë.

**Marçela Shehu:** Më fal edhe diçka, lidhur me afatin, nuk mund të kemi një propozim, duke qenë se dy nga anëtarët...

*(Kryetarja flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Naureda Llagami:** Ju kur flisni për propozim, vetëm kundërshtoni. Akoma s'e kuptoni që kur kundërshtohet, jepet propozimi konkret.

**Marçela Shehu:** Jo, e dashur Kryetare, e kemi kuptuar.

Ne e ngritëm në pyetjeje. Pra debati jonë ishte në formë pyetjeje dhe pyetja konsistonte në: -A ka një afat të përcaktuar nga ligji që përfshin këtë afatin që dyjavor? Nuk kishte.

**Naureda Llagami:** Unë ju thashë që, me miratimin e strukturës që është miratuar javës që vjen, detyrimi për t'u shprehur për statusin ka të bëjë me detyrimet financiare. Nëse detyrimet financiare për juve nuk janë të ndjeshme, kjo do të thotë që ne mund të

marrim sanksione si institucion lidhur me pagesat që bëjmë në mënyrë të paligjshme. Për mua ky është shqetësim primar. Nëse për ju s'është, -okej, është problem i juaj. Prandaj, afati dyjavor, mos të harrojmë që edhe dosjet personale, bëhet fjalë për 7-8 persona pra, nuk kemi ndonjë volum kushedi se çfarë. Gjithashtu stafi është i gatshëm që t'ju ofrojë të gjithë asistencën e vet lidhur me hartimin e raportit.

Diskutime të tjera?

Propozim tjetër?

Jo!

Kalojmë në votim të projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Akti miratohet sipas propozimit të bërë nga kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë kalojmë në hedhjen e procedurës së shortit për përcaktimin e anëtarëve të këtij komisioni.

**Elis Kuçi:** Si fillim do të zgjedhim anëtarët jo gjyqtarë që janë dy. Dhe në gogla do të vihen 4 shirita (2 'anëtar' dhe 2 'jo anëtar').

*(Pas futjes së shiritave në gogla, fillon shorti.)*

Tani mund të vijmë të zgjedhim 4 anëtarët jo gjyqtarë.

*(E para që për zgjedh goglën është zonja Fatmira Luli.)*

Zonja Luli, anëtare.

*(I dyti që për zgjedh goglën është zoti Alban Toro.)*

Zoti Toro, jo anëtar.

*(I treti që për zgjedh goglën është zoti Erjon Muharremaj.)*

Zoti Muharremaj, jo anëtar.

*(I katërti që për zgjedh goglën është zoti Maksim Qoku)*

Zoti Qoku, anëtar.

Tashmë vazhdojmë shortin për të zgjedhur 1 anëtar nga gjyqtarët. Do jenë 6 gogla, ku 5 do jenë 'jo anëtar' dhe 1 'anëtar'.

*(Pas futjes së shiritave në gogla, fillon shorti.)*

*(E para që për zgjedh goglën është zonja Marçela Shehu.)*

Zonja Shehu, jo anëtar.

*(I dyti që për zgjedh goglën është zoti Dritan Hallunaj.)*

Zoti Hallunaj, jo anëtar.

*(I treti që për zgjedh goglën është zoti Ilir Toska.)*

Zoti Toska, jo anëtar.

*(I katërti që për zgjedh goglën është zonja Brikena Ukperaj.)*

Zonja Ukperaj, jo anëtar.

*(I pesti që për zgjedh goglën është zonja Brunilda Kadi.)*

Zonja Kadi, jo anëtar.

*(I gjashti që për zgjedh goglën është zoti Medi Bici.)*

I fundit, zoti Bici, anëtar.

**Naureda Llagami:** Po! Pas zgjedhjes së shortit, anëtarët e Komisionit të përkohshëm, të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi janë: Zonja Fatmira Luli, zoti Maksim Qoku dhe zoti Medi Bici.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 24.04.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)

*10. Erjon Muharremaj (anëtar)*

*11. Marçela Shehu (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 5. Marjana Papa, OSCE.*
- 6. Sindi Liço, Qendra Evropiane.*
- 7. Migena Kondo, KSHH.*
- 8. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Erjon Fejzulla, USAID.*
- 11. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 12. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimeve mbi fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Atëherë, në vijim të rendin të ditës, kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, pika 4, e cila ka të bëjë me fillimin e procedurës të transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Për më shumë informacion fjalën ia kaloj zonjës Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Po! Faleminderit, Kryetare!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në shqetësimin e ngritur nga kryetarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si dhe nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, lidhur me ngarkesën dhe situatën që është krijuar në këto gjykata për shkak të organikës së tyre të cunguar, ky Komision i propozon Këshillit për të nisur procedurat për transferim të përkohshëm të një gjyqtari, pikërisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Shkodër dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Lidhur me situatën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, rezulton se me shkresën nr. 206 prot., datë 15.02.2019, kryetarja e kësaj gjykate informon se deri më datë 13 shkurt 2019, numër i çështjeve administrative të regjistruara në këtë gjykatë në total është 1105. Kjo ngarkesë aktualisht shpërndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet 2 gjyqtarëve të gjykatës që janë gjyqtarët {...}, njëkohësisht dhe kryetare e gjykatës, e cila ka 533 çështje administrative dhe gjyqtari tjetër {...}, i cili është gjyqtar i transferuar në këtë gjykatë deri më 14 qershor 2019, i cili ka aktualisht në gjykim 572 çështje administrative. Gjyqtarët po shqyrtojnë edhe çështjet që kanë qenë për gjykim pranë gjyqtarit {...} që i përkasin vitit 2016-2017. Në këto kushte për shkak të ngarkesës së madhe të gjykatës, kryetarja e kësaj gjykate i ka kërkuar Këshillit për të marrë masa për zgjidhjen e kësaj situate.

Nga verifikimet e bëra nga ana e Komisionit, rezulton që sipas dekretit nr.7818, datë 16.11.2012 organika administrative e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka 4 gjyqtarë. Aktualisht funksionin e gjyqtarit e ushtrojnë 2 gjyqtarë. Gjyqtarja {...} e cila është njëkohësisht dhe kryetare e gjykatës dhe gjyqtari {...} i cili është transferuar përkohësisht me vendimin nr. 47, datë 13.06.2018 “Mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në disa gjykata”, dhe më datë 13.06.2019, bazuar në këtë vendim, gjyqtari {...}, pas përfundimit të afatit njëvjeçar, rikthehet sërish në gjykatën nga ku është transferuar.

Rezulton që të emëruar në mënyrë të përhershme pranë kësaj gjykate janë gjyqtarët {...} dhe {...} (ky i fundit i shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit), pra është i pezulluar. Në këto kushte, rezulton që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, aktualisht ka dy pozicione të lira të përhershme dhe një pozicion të lirë të përkohshëm.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura, Komisioni vlerëson se nevojat për delegime të paraqitura nga kjo gjykatë nuk mund të plotësohen nëpërmjet skemës së delegimit sipas vendimit nr. 22, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pasi në skemën e delegimit nuk ka gjyqtarë të disponueshëm. Gjithashtu Komisioni vlerëson se këto nevoja nuk mund të plotësohen as nëpërmjet përcaktimeve të vendimit nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e vendimit për rregullat e procedurës së caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron në mënyrë të përhershme funksionin”, për shkak se, në pikën 2 të këtij vendimi parashikohet se: Ky vendimin aplikohet në rast të pamundësisë së zbatimit të neneve 45 dhe 46 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson së në rastin konkret, për plotësimin e nevojave të paraqitura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, Këshilli duhet të orientohet në përcaktimet e vendimit nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për mënyrën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, duke shpallur një pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë kësaj gjykate.

Duke u bazuar në faktin e parashtruar më sipër, që nuk ka gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit si dhe duke vlerësuar që nuk mund të zbatohen parashikimet e vendimit për caktimin e gjyqtarit për një çështje të veçantë, i cili në çdo rast aplikohet në ato raste kur nuk mund të aplikohet neni 45 dhe 46 i ligjit “Për statusin...”.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në vendimet e sipërcituara të KLGJ si dhe në referim të vendimit nr. 23 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit”, Komisioni vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër do të konsiderohet gjykatë në nevojë. Neni 3 i rregullores së transferimit parashikon se: “Gjykatë në nevojë nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj”.

Në rastin konkret, rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka një pozicion të lirë të përkohshëm dhe aktualisht është cenuar funksionimi normal i saj duke konsideruar edhe numrin e madh të kërkesave për delegim të paraqitura në Këshill nga kryetarja e gjykatës si dhe faktin që organika e gjykatës nuk është e plotë, pasi rezulton të ketë dhe dy pozicione të lira të përhershme.

Në këto kushte Komisioni vlerëson se duhet të nisë procedurat për transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Lidhur me gjykatën e cila do t'i nënshtrohet procedurës së transferimit, Komisioni ka propozuar dy variante:

Sipas variantit të parë, bazuar në përcaktimet e vendimin 23 si dhe pas verifikimit paraprak të ngarkesave të gjykatave, komisioni vlerëson se gjykata nga e cila duhet bërë transferimi i përkohshëm i një gjyqtari për në Gjykatën Administrative Shkodër, bazuar në faktin që kjo është një gjykatë e posaçme dhe në rregullore është parashikuar që transferimi për gjykatat e posaçme do të behët, kur është e mundur, brenda këtyre gjykatave dhe nga verifikimi i ngarkesave që ka bërë Komisioni rezulton që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është gjykata më e përshtatshme për të nisur procedurat për transferimin e përkohshëm të një gjyqtari.

Kjo gjykatë rezulton si gjykatë me ngarkesë mesatare më të ulët për gjyqtar. Aktualisht mesatarja për gjyqtar në këtë gjykatë është 73 çështje, krahasimisht me gjykatat e tjera administrative të shkallës së parë dhe nuk ka problem me funksionalitetin e saj, pasi organika e saj është e plotë. Ndërsa gjykatat e tjera administrative të shkallës së parë, përveç ngarkesës së tyre të lartë, kanë mangësi dhe në organikat e tyre.

Kështu, përveç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë që ka organikë të plotë, por ngarkesë të lartë, 114 çështje për gjyqtar është mesatarja, gjykatat e tjera paraqesin problematika në organikat e tyre. Kështu, Gjykatat Administrative Shkalla e Parë Gjirokastër ka 2 pozicione të lira të përhershme, pra ka probleme në organikën e saj. Gjykata Administrative Shkallës së Parë Korçë ka 2 pozicione të lira ta përhershme. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka 1 pozicion të lirë të përhershëm.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të shpallë 1 pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës

së Parë Shkodër; Ta autorizojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm lidhur me procedurën e transferimit dhe të përcaktojë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykata nga e cila do të kryhet transferimi i përkohshëm i gjyqtarit, për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Si variant të dytë, duke dalë nga transferimi brenda gjykatave të së njëjtës lëndë, Komisioni propozon që transferimi të bëhet nga gjykatat më të afërta nga pikëpamja gjeografike me gjykatën në nevojë, të vendosura jo në të njëjtin juridiksion territorial apeli me gjykatën në nevojë, pasi rezulton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është e vetmja gjykatë nën juridiksionin territorial të Gjykatës së Apelit Shkodër (administrativ), por nga gjykatat më të afërta që ndodhen nën juridiksionin territorial të gjykatave më të afërta të apelit.

Bazuar në këtë kriter, Komisioni propozon si gjykata nga mund të bëhet transferimi i përkohshëm Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, që i përkasin juridiksionit territorial të Gjykatës së Apelit Shkodër, si të vetmet gjykata të këtij juridiksioni nga ku mund të bëhet transferimi i përkohshëm, pasi gjykatat e tjera që i përkasin këtij juridiksioni kanë problematika lidhur me organikat e tyre, të tilla që cenojnë funksionalitetin e këtyre gjykatave. Kështu Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka dy vende të lira të përhershme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka një vend të lirë të përhershëm, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka një vend të lirë të përhershëm.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë aktualisht rezulton të ketë një ngarkesë mesatare çështjesh për gjyqtar 104 çështje, por duke konsideruar që kryetarja e gjykatës ka reduktim të ngarkesës, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton me një ngarkesë mesatare çështjesh 115 çështje për gjyqtar.

Këto dy gjykata rezultojnë me ngarkesë mesatare më të lartë çështjesh për gjyqtar, në krahasim me Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të propozuar në variantin A.

Bazuar sa më sipër, ky Komision i propozon Këshillit: Të shpallë një pozicion të lirë të përkohshëm pranë kësaj gjykate; Të autorizojë Komisionin të vijojë me procedurat

përkatëse dhe; Të përcaktojë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Shkodër, si gjykata nga të cilat do të kryhet transferimi i përkohshëm.

Ky është propozimi në dy variante.

Ose, ky propozim vjen tani nga unë, në mënyrë verbale, nëse Këshilli e vlerëson, në procedurën e transferimit mund të përfshihen të tre gjykatat që Komisioni ka vlerësuar në variante të veçanta. Pra të përfshijë në procedurat e transferimit Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të filluar me marrjen e pëlqimit dhe më pas me... Po, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore Lezhë dhe Shkodër. Ky është propozimi i Komisionit.

**Naureda Llagami:** Kemi diskutime lidhur me propozimin e bërë?

**Maksim Qoku:** Vetëm një sqarim desha.

Duke qenë që në këto gjykata ka të transferuar dhe meqë e kanë transferimin me vit, gjykoj që e kanë pa pëlqim. A mundet të aplikohet paragrafi i dytë, t'iu merret pëlqimi këtyre?

Mund t'u merret edhe këtyre që janë, apo duhet të mbarojnë...? Kjo është ideja. Për sqarim kjo.

Mund të them diçka, në lidhje me, meqë merrem me hartën gjyqësore dhe kam parë largësitë gjeografike, midis Burrelit dhe Tiranës, ka të njëjtën largësi gjeografike (tek 50 km), në lidhje me Kurbinin.

*(Zonja Shehu flet pa ndezur mikrofonin.)*

Do merremi me Shkodrën përpara. Jam dakord.

**Naureda Llagami:** Kemi diskutime?

*(Zonja Shehu flet fillimisht pa ndezur mikrofonin, më pas e ndez si më poshtë.)*

**Marçela Shehu:** ... i fundit, do futen të gjitha gjykatat në një propozim, për të filluar marrjen e pëlqimit dhe më pas për të kaluar tek transferimi, nëse e vlerëson Këshilli.

Që të jemi pak më konciz. Kemi variantin e parë, me propozim Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; kemi propozimin e dytë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Shkodër, që janë më të afërta nga pikëpamja gjeografike dhe; kemi

një variant të tretë që i përfshin të tre këto gjykata, nëse Këshilli e vlerëson që duhet të përfshihen të tre gjykatat në procedurat e transferimit, sidomos në marrjen e pëlqimit.

**Naureda Llagami:** Zoti Toska!

**Illir Toska:** Duhet të fillojmë nga propozimi i fundit, sepse nëse s'biem dakord që duhet të jenë të gjitha, do të fillojmë të votojmë ato veç e veç.

**Brunilda Kadi:** Mund të them diçka unë?

Një konsideratë në lidhje me variantin C. Sepse mund të ndodhë që ne pëlqimi do na vijë nga një gjykatë që na prish punë. Pastaj si do ta kushtëzojmë vendimmarrjen? Tek varianti C ishte që të futen të gjitha gjykatat.

**Marçela Shehu:** Jo! Këto të treja.

**Brunilda Kadi:** Varianti i parë është Tirana.

Varianti i dytë është Lezha, Shkodra.

**Marçela Shehu:** Varianti i tretë, të treja bashkë.

**Brunilda Kadi:** Varianti i dytë është, o njëra, o tjetrën, o tjetrën?

**Marçela Shehu:** Po!

**Brunilda Kadi:** Ah, se nuk u kuptua dy-shi me tre-shin si variant.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë për votim?

Kemi më propozime lidhur me propozimet e Komisionit? Sqarime?

Atëherë, kalojmë me propozimin e relatorit.

Kalojmë në votim variantin e tretë, ku përfshihen të gjithë gjykatat, të tre gjykatat.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.



**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet varianti i tretë, i propozuar nga relatori në seancën plenare, ku do përfshihen në dhënien e pëlqimit të tre gjykatat.

Vazhdojmë tek çështja tjetër, lidhur me fillimin e procedurës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Prapë fjalën ia japim relatores së projekt-aktit, zonjës Shehu.

**Marçela Shehu:** Po!

Edhe situata në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kubin është pak a shumë e njëjtë. Aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin e gjyqtarit 2 gjyqtarë, pasi 2 gjyqtarë të tjerë, njëri është anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa anëtari tjetër është shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe përkohësisht është i pezulluar.

Në këtë gjykatë, aktualisht ka dy pozicione të lira të përkohshme. Kjo situatë, pra gjykimi me 2 gjyqtarë, në vend të 4 gjyqtarëve, ka ndikuar në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve pranë kësaj gjykate dhe në rritjen e numrit të kërkesave për delegime. Aktualisht, mesatarja e çështjeve për gjyqtar në këtë gjykatë është 195.

Komisioni ka vlerësuar se edhe në rastin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin nuk mund të procedohet me aplikimin e nenit 45 dhe 46 të ligjit “Për statusin...”, nenit 45 të ligjit “Për statusin...”, pasi nuk kemi gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit dhe në këto kushte Komisioni vlerëson se jemi në kushtet e aplikimit të nenit 46 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që lidhet pikërisht me procedurat e transferimit”.

Në këto kushte, Komisioni propozon të shpallë një pozicion të lirë të përkohshëm për transferim pranë kësaj gjykate, duke u bazuar në faktin e parashtruar, se nuk ka gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit, si dhe duke vlerësuar që nuk mund të zbatohen parashikimet e vendimit për caktimin e gjyqtarit për një çështje të veçantë.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në referim të vendimit nr. 23, Komisioni vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin do të konsiderohet gjykatë në nevojë.

E cituam edhe pak më parë, sipas nenit 3 të rregullores, gjykatë në nevojë kemi përcaktuar gjykatën e cila ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionalitetin e saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin rezulton të ketë dy pozicione të lira të përkohshme. Kjo situatë ka ndikuar në funksionalitetin e saj, sidomos në gjykimin e çështjeve penale, të cilat pas ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale, kërkojnë në gjykim implikimin e të paktën 3 gjyqtarëve, gjyqtarin që shqyrton kërkesat gjatë hetimit paraprak, gjyqtarin e seancës paraprake dhe gjyqtarin që gjykon themelin e çështjes. Në situatën aktuale, kjo gjykatë në shumicën e çështjeve penale, do të parashtrrojë kërkesa për caktim gjyqtari për shkak të mungesave të saj në organikë.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se duhet të nisë procedurat për transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Edhe për rastin e Kurbinit, Komisioni ka paraqitur tre variante propozimi. Po paraqesim edhe një variant të katërt në seancë, duke përfshirë si në rastin e administratives Shkodër, të gjitha gjykatat që janë përfshirë në tre variantet e mëparshme.

Në variantin e parë, Komisioni ka përcaktuar si gjykatë nga e cila duhet të bëhet transferimi Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është gjykatë në të njëjtin juridiksion apeli me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ka aktualisht 68 gjyqtarë që ushtrojnë detyrën pranë kësaj gjykate dhe transferimi i përkohshëm nuk cenon funksionalitetin e saj, krahasimisht me gjykatat e tjera që ndodhen në të njëjtin juridiksion apeli, siç janë Gjykata e Rrethit Mat, Krujë dhe Dibër, funksionaliteti normal i të cilave do të cenohej, nëse transferimi i përkohshëm do të realizohej nga këto gjykata. Në Krujë ushtrojnë funksionin 3 gjyqtarë dhe në këtë gjykatë ka një pozicion të lirë të përhershëm; në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat ka një organikë të plotë, por detyrën e gjyqtarit e ushtrojnë 3 gjyqtarë, pasi një gjyqtar është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës; ndërsa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër ushtrojnë aktualisht funksionin 3 gjyqtarë dhe rezulton të ketë një vend të lirë të përhershëm.

Ngarkesa mesatare për gjyqtar e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është: Seksioni civil – 126 çështje/gjyqtar; ndërsa seksioni penal – 66 çështje/gjyqtar.

Pra sipas variantit të parë, Komisioni vjen pikërisht me këtë propozim, duke propozuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykatë nga e cila do të kryen procedurat e transferimit.

Në variantin e dytë, Komisioni ka propozuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, e cila edhe kjo gjykatë ndodhet në të njëjtin juridiksion apeli.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka 4 gjyqtarë në organikë. Funkcionin e gjyqtarit e ushtrojnë 3 gjyqtarë. Njëri gjyqtar është i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, deri më 13.06.2019.

Ngarkesa për gjyqtar e kësaj gjykate është 45 çështje për gjyqtar.

Nëse Këshilli do të vlerësojë që transferimi do të bëhet pikërisht nga kjo gjykatë, atëherë do të kemi parasysh që efektet e këtij vendimi do të parashikohen të hyjnë në fuqi pas datës 13.06.2019, pra pas përfundimit të transferimit të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Kukësit.

Si propozim të tretë, Komisioni propozon Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila nuk ndodhet në të njëjtin juridiksion apeli, por ka afërsi gjeografike me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Kjo gjykatë ka në organikë 17 gjyqtarë. Ushtrojnë aktualisht funksionin 14 gjyqtarë. Ngarkesa mesatare e kësaj gjykate është 90 çështje për gjyqtar.

Ndërsa varianti i katërt, nëse Këshilli vlerëson, që në procedurat e transferimit të përfshihen të tre gjykatat që janë të ndara në tre variante të ndryshme. Pra një variant i katërt, ku procedura të përfshijë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Mat dhe Kukës.

S'ë di nëse ka ndonjë pyetje.

*(Zonja Shehu bën një korrigjim.)*

Tiranë, Mat dhe Durrës.

**Medi Bici:** Kisha unë një sqarim për ta informuar Këshillin. Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat duhet ta përjashtoni, se aktualisht funksionon me 2 gjyqtarë sepse njëri prej gjyqtarëve është marrë me helikopter nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Është operuar para 1 jave në spitalin e Tiranës, në spitalin civil dhe është vështirë të bëhet për punë për një kohë të gjatë. Gjyqtari {...}. Kështu që funksionon me 2 gjyqtarë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

**Marçela Shehu:** Atëherë, edhe unë personalisht jam në dijeni të këtij fakti. Zoti {...} është edhe pranë moshës së pensionit dhe herë pas here ka pasur probleme shëndetësore kardiake. Në këto kushte Komisioni propozon që si variant të katërt, të mos

përfshihet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, por të jetë vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës.

Atëherë, duke u tërhequr tek varianti i Matit, Komisioni propozon të shtohet si variant që procedurave të transferimit për Gjykatën e Kurbinit t'i nënshtrohen Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi diskutime lidhur me propozimin e paraqitur nga relatorja dhe Komisioni? Kemi diskutime?

Jo!

Atëherë, kalojmë tek votimi i propozimit të bërë nga Komisioni, varianti ku përfshihen të dyja gjykatat.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të bërë nga relatorja e projekt-aktit.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 24.04.2019)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Dhënie e opinionit mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Marjana Papa, OSCE.*
6. *Sindi Liço, Qendra Evropiane.*
7. *Migena Kondo, KSHH.*
8. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Erjon Fejzulla, USAID.*
11. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
12. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Dhënie e opinionit mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek pika e pestë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me miratimin e një opinionit në formën e një projektvendimi për dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për t'u komanduar në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës. Për më shumë informacion, fjalën po ia kaloj zonjës Shehu, lidhur me këtë projekt-akt.

*Marçela Shehu:* Po! Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 264 dhe 265 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, mbi kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 33, datë 19.02.2019, shpalli hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t'u komanduar, me

pëlqimin e tyre, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Vendimi si më lart i Këshillit të Lartë Gjyqësor është shpallur në faqen zyrtare të internetit më datë 26.02.2019, ndërsa afati i paraqitjes së kërkesave për komandim në vendin vakant është përcaktuar 3 javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, afat ky që përfundonte më datë 19.03.2019.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pra brenda datës 19.03.2019, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë paraqitur kërkesë 2 gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe konkretisht: znj. {...} dhe z. {...}.

Në respektim të përcaktimit të bërë në pikën 4, të nenit 54, të ligjit 96/2016, sa i përket vlerësimit të Këshillit nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, Komisioni vlerëson/çmon se komandimi i 2 kandidatëve në rastin konkret nuk vjen ndesh me interesat e lartë të gjykatës, në ato gjykata ku ato ushtrojnë funksionin e gjyqtarit.

Për këtë mbahet në konsideratë fakti se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane është gjykata më e madhe në vend, me një organikë gjyqtarësh relativisht të lartë (përbëhet nga 75 gjyqtarë), ndërsa ka vetëm 4 pozicione të lira të përhershme.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson...

Pesë (5).

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se komandimi i znj. {...} ose z. {...} në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës, vlerësohet se nuk pas sjellë cenim të interesave të larta të kësaj gjykate, për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj, ndërsa kjo gjykatë, në rrethanat aktuale, ka mjaftueshëm gjyqtarë për ofrimin e shërbimit gjyqësor.

Nisur nga kjo, është vendi për dërgimin Shkollës së Magjistraturës të emrave të 2 kandidatëve, znj. {...} dhe z. {...}, që kanë aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për të vijuar me tej, kjo e fundit, me procedurën e emërimit për këtë pozicion.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: T'i dërgohen Shkollës së Magjistraturës emrat e znj. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë aplikuar për t'u komanduar, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej tyre, si dhe; Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Kemi diskutime lidhur me propozimin e bërë nga Komisioni përkatës për dhënien e opinionit të dy kandidaturave?

Kalojmë në votim opinionin sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Pro.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Kundër.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 24.04.2019)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi statusin e magjistratit dhe mbarimin e tij për disa ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që iu ka mbaruar mandati”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, e konkretisht për ish-gjyqtarët:

- {...};
- {...};
- {...};
- {...};
- {...}.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>11. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
- 5. Marjana Papa, OSCE.*
- 6. Sindi Liço, Qendra Evropiane.*
- 7. Migena Kondo, KSHH.*
- 8. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Erjon Fejzulla, USAID.*
- 11. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 12. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi statusin e magjistratit dhe mbarimin e tij për disa ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që iu ka mbaruar mandati”, për gatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, e konkretisht për ish-gjyqtarët:

- {...};
- {...};
- {...};
- {...};
- {...}.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek pika e gjashtë të rendit të ditës, e cila lidhet me projektvendimin “Mbi statusin e magjistratit dhe mbarimin e tij për disa ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që iu ka mbaruar mandati”.

Siç ju kemi bërë në dijeni, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka mbërritur praktika nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, përmes të cilës kërkohet për këto ish-gjyqtarë vlerësim dhe qëndrim mbi procedurat për statusin e magjistratit, bazuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht për zotin {...}, {...}, {...}, {...} dhe zonjën {...}.

Po ashtu, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë mbërritur edhe shkresat nga vëzhguesit ndërkombëtarë pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, përmes të cilave Këshillit i kërkohet sqarim mbi mbajtjen e statusit të magjistratit pas mbarimit të mandatit gjyqtar për gjyqtarët respektivë: {...}, {...} dhe z. {...}.

Siç jeni në dijeni, në dokumentet shoqëruese të kësaj pike ka edhe një praktikë dokumentare të korrespondencës së zhvilluar midis Gjykatës së Lartë, Presidentit të Republikës dhe ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për 5 ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe një korrespondencë të këtyre të fundit me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Për më tepër informacion, fjalën po ia kaloj kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska, për të dhënë më shumë sqarime lidhur me projektvendimin.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, është përgatitur një relacion me shkrim që është paksa i gjatë.

Janë referuar shkaqet e vënies në lëvizje të këtij procesi nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Është evidentuar fakti që ka mbërritur nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit një kërkesë e këtij Komisioni por bashkëlidhur edhe një praktikë dokumentare e korrespondencës së këtij Komisioni me 5 ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që u ka mbaruar mandati më datë 28 korrik të vitit 2017, pra për zotin {...}, {...}, {...}, {...} dhe zotin {...}. Ndërkohë brenda kësaj praktike dokumentare ka edhe një korrespondencë e këtyre ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë me ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Po kështu, për 3 nga ish-gjyqtarët e përmendur më lart, ka edhe një kërkesë nga Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, ku kërkohet, nga ana e Këshillit, të vlerësojnë mbajtjen ose jo të statusit të magjistratit për 3 ish-gjyqtarë konkret të ish-Gjykatës së Lartë.

Në relacion janë evidentuar faktet që lidhen me karrierën e 5 ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, momentin e emërimit në Gjykatën e Lartë, momentin e deklarimit të mandatit, momentin e dorëzimit të detyrës, si dhe çka ngjarë mbas dorëzimit të detyrës nga ana e tyre, referuar fakteve të referuara nga vetë ata si dhe dokumentat e përcjella në korrespondencë më pas më herët me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit apo me ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Është referuar më tej në relacion ligji i kohës kur është bërë emërimi në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë për 5 ish-gjyqtarët që u ka mbaruar mandati, si dhe ligji i kohës në momentin që është deklaruar mbarimi i mandatit të tyre si gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

Më tej janë dhënë opinione dhe vlerësime rreth mbajtjes së statusit të magjistratit. Sipas njërit opinion, referuar përcaktimit të bërë në Kushtetutë, neni 139/3, ku bëhet fjalë për procedurë emërimi. Referuar këtij opinion konsiderohet që mandati i 5 ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ka mbaruar në momentin që ka mbaruar... statusi i magjistratit për 5 ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, ka mbaruar në momentin që ka mbaruar mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, sa kohë që sipas Kushtetutës kërkohet një emërim për ta në një pozicion tjetër që sipas ligjit është në pozicion nivel apeli.

Referuar ligjit të statusit ku përcaktohet se statusin e gëzon magjistrati nga momenti i emërimit dhe deri në deklarimin e mbarimit të statusit, sipas këtij opinion, sa kohë u kërkohet një emërim për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, këta magjistratë, pra 5 ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, iu ka mbaruar mandati për shkak se nuk kanë një emërim në nivel apeli dhe duke mos pasur një të tillë, nuk gëzojnë statusin e magjistratit mbas momentit të mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Sipas opinionit tjetër, është që 5 ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët e gëzojnë statusin e magjistratit sipas ligjit, që ka përfshirë edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë në detyrë, vijojnë ta gëzojnë këtë status edhe pas mbarimit të mandatit të anëtarit të

Gjykatës së Lartë, referuar faktit se ligji iu ka njohur të drejtën e caktimit në nivel apeli. Në këto kushte, sa kohë që me veprime konkludente, pra derisa nuk kanë kërkuar që të caktohen në nivel apeli, por përkundrazi kanë konsideruar të fillojnë një aktivitet profesional privat, si dhe për faktin se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, gjatë këtij procesi, për të konsideruar nëse kanë apo jo interes për t'u caktuar në nivel apeli, kërkoi edhe një herë me shkrim që të shprehen për 5 ish-gjyqtarët dhe të 5-të deklaruan se nuk kanë ndonjë interes të tillë, sipas variantit të dytë, deklarimi i mbarimit të statusit duhet të bëhet për shkak të heqjes dorë nga e drejta për t'u caktuar në nivel apeli.

Ky është propozimi i bërë nga ana e Komisionit për të 5-të ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë: zotin {...}, zonjën {...}, zotin {...}, zonjën {...} dhe zotin {...}.

Bashkëlidhur praktikës janë edhe korrespondencat e mëhershme për 5 ish-gjyqtarët me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit apo me ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, si dhe mungesa e shprehjes së interesit për t'u caktuar në nivel apeli, e marrë vetëm në datë 8 prill të vitit 2019 mbi kërkesën që Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsideroi t'ia referojë këtyre 5 ish-gjyqtarëve. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi diskutime për këtë?

Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Jam kundër përfshirjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor në komunikime interpretative në lidhje me statusin e subjekteve të bërë nga institucione apo aktorë të ndryshëm publikë. Secili nga institucionet publike, konform parimit të ligjshmërisë dhe të marrjes së vendimeve të përcaktuara në nenet 4 dhe nenin 16 të Kodit të Procedurës Administrative, kanë diskrecion të shprehen me vendimmarrje të veçantë kur u kërkohet për një problematikë të caktuar. Në këtë kuadër, propozimi im konsiston në faktin që KLGJ të mos shprehet për këtë lloj kërkimi.

Nëse s'do pranohet dhe do vazhdohet më tej për propozimet që janë, jam për variantin 2, të propozuar nga ky Komision.

**Ilir Toska:** Atëherë, marrë shkas nga opinioni i zotit Toro. Qëndrimi im personal është që Këshilli, në çdo rast, për sa kohë i referohet rrethana, që sipas ligjit të statusit të konsiderojmë mbarimin e statusit të magjistratit, ka obligimin ligjor që të deklarojë mbarimin e statusit. Në rastin konkret, vënia në lëvizje e procesit, ka ardhur vërtet nga

KPK, por praktika dokumentare si dhe kërkesat që kanë paraqitur vetë 5 ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, janë rrethana mbi të cilat Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet t'i konsiderojë për deklarinimin e mbarimit të statusit të tyre. Pra nuk duhet të interpretohet sikur ne kemi ndërmarrë këtë veprim mbi kërkesën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit apo një subjekti tjetër. Rrethanat që përlligjin këtë vendimmarrje të Këshillit janë bërë prezent para Këshillit dhe Këshilli ka obligim të konsiderojë mbajtjen ose jo të statusit të magjistratit apo të deklarojë mbarimin e tij për 5 ish-gjyqtarët që referohet më lart. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi diskutime të tjera?

Po!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë së pari, mendoj që Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka kompetencë, nuk e autorizon ligji që të deklarojë mbarimin e mandatit apo edhe të statusit të anëtarit të Gjykatës së Lartë sepse mendoj që Kushtetuta dhe ligji është i qartë për këtë pjesë.

Jam dakord me atë që tha zoti Toro që, jo vetëm dispozitat që referoi por edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese thotë që ligjin e interpreton organi që e zbaton dhe ne, që ta interpretojmë ligjin, duhet të kemi një rast konkret. Sikundër thashë në pikën e parë, mendoj që s'e kemi rastin sepse nuk e kemi detyrim. Ndërkohë, bazuar në parimin dhe detyrimin ligjor që kemi ne si institucion për të bashkëpunuar me organet e rivlerësimit, nisur edhe nga kërkesa e tyre, nga shkresa që na u vu në dispozicion dje, pra shkresa e KPK dhe ONM, ata kërkojnë opinion, nuk kërkojnë vendim. Nuk do të thotë që po të kërkonin vendim ata, automatikisht të merrnim vendimin, po flas që kërkesa e tyre është që të jepet një opinion dhe unë, për të gjithë arsyet që thashë më lart, mendoj që Këshilli të japë një opinion në lidhje me statusin e këtyre ish gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe mendoj që ndoshta duhet të hidhet në fillim ky si propozim, që në varësi të vendimmarrjes pastaj, të ecet, që të shprehim edhe konsideratat pastaj për lëndën, për themelin dhe përmbajtjen e vendimmarrjes, nëse do ketë, do dalim me vendim për deklarinimin e mbarimit të mandatit, do ta rimarrë fjalën nëse Këshilli do votojë pro atij varianti.

**Naureda Llagami:** Atëherë, ndonjë diskutim?

**Brunilda Kadi:** Atëherë, propozimi im dhe besoj edhe i zotit Toro është që ne të japim opinion, jo të marrim... E keqkuptova. Më fal.

Atëherë, unë propozoj që Këshilli të japë, të vendosë të japë një opinion, jo të marrë vendim për të deklaruar mbarimin e mandatit apo të statusit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Gjë që bën të njëjtën punë si dhe vendimi, për arsyet që thashë më lart.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi diskutime?

Atëherë, i hedhim në procedurë.

**Fatmira Luli:** Të flas edhe unë? T'i them dhe unë dy gjera?

**Naureda Llagami:** Patjetër!

**Fatmira Luli:** Unë gjykoj që ne duhet të shprehemi me vendim, se në bazë të nenit 65 të ligjit "Për statusin e gjyqtarit" është detyra e Këshillit që të shprehet për mbarimin e statusit, në një kohë që ne administrojmë disa kërkesa të tyre, për heqje dore nga e drejta e emërimit në gjykatën e apelit, dhe kjo nënkupton që ata kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për të mbajtur statusin.

Në këto kushte, duhet të dalim me vendim. Kompetencat tona nuk na e kryejnë... institucionet e tjera mund të bëjnë interpretime por vendimin për mbarimin e statusit e ka vetëm Këshilli, dhe asnjë institucion tjetër.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Luli.

Atëherë, pa hyrë tek propozimi. Për procedurë unë mendoj që ne duhet të kalojmë fillimisht për miratim propozimin e bërë nga zoti Toro, që këtë kërkesë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Këshilli mos të shprehet, lidhur me kërkesën e tyre dhe më pas kalojmë për votim propozimin e bërë nga zonja Kadi që Këshilli nuk duhet të shprehet me vendim por duhet të shprehet me opinion lidhur me statusin e ish...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Me vendim për deklarimin e mbarimit të statusit.

**Naureda Llagami:** E pra, Këshilli nuk duhet...

Atëherë po e riformuloj, po them Këshilli duhet të japë opinion lidhur me statusin e ish 5 gjyqtarëve. Dakord?

Kalojmë në votim propozimin e bërë nga zoti Toro.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Kadi lidhur me dhënien e opinionit në këtë rast nga Këshilli për këtë çështje.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Atëherë, kalojmë lidhur me shkakun pra projekt-aktin lidhur me shkakun e dhënies së dorëheqjes.

Propozimi i parë i dhënë nga zonja Luli dhe nga Komisioni ishte që për mbarimin e statusit për dhënien e dorëheqjes duhet të jetë heqja dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivelin e gjykatës së apelit. Pra, jemi dakord për këtë?

Atëherë, ngaqë e propozoi Fatmira mendova që ta kalonim dhe atë si propozim të shkakut. Po, është i dyti. Dakord.



Atëherë hedhim në votim që mbarohet statusi, variantin e propozuar nga Komisioni, variant i parë, sipas të cilit statusi i 5 anëtarëve, të 5 ish-gjyqtarëve...

Jeni dakord që të deklarojmë mbarimin e statusit për 5 ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord. Me arsyetimin që thashë, unë isha kundër por në kushtet që Këshilli vendosi që do eci me këtë, tani unë do votoj në lidhje me përmbajtjen e vendimit dhe jam pro që të deklarohej tani mbarimi i statusit.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

Ah, deklarimin e mbarimit.

Pro.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

*(Vota e zotit Bici nuk është regjistruar për shkak se nuk ka pasur të ndezur mikrofonin. Edhe zoti Bici është pro.)*

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë propozimi i parë i bërë nga Komisioni lidhur me shkakun e mbarimit të statusit për arsye të mbarimit të mandatit... Po pra, se kështu thotë.

**Maksim Qoku:** Jam kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Atëherë, shkak u për të cilën... Atëherë shkak u i mbarimit të statusit të magjistratit për ish 5 gjyqtarët e Gjykatës së Lartë është heqja dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivelin e gjykatës së apelit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Kundër, dhe votën kundër do ta shpjegoj më vonë apo...? Si të doni. Ta shpjegoj tani? Okej.

Unë vlerësoj që statusi i magjistratit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron me mbarimin e mandatit dhe këtë e përcakton dhe Kushtetuta dhe ligji, sipas vlerësimit tim. Fakti që ky gjyqtar, ish-gjyqtar, ka të drejtën sipas ligjit “Për statusin” dhe sipas Kushtetutës, e cila referon në kriteret e posaçme të ligjit, që autorizon pra ligjin të vendosë kriteret të posaçme është një e drejtë që e kanë këta gjyqtarë me këtë status por është një e drejtë që e para, duhet të kërkohet, e dyta duhet të plotësojë kriteret dhe e treta duhet të vendosë Këshilli. Pra vendimi i Këshillit është hapi i fundit që këta, për mua, e rimarrin statusin n.q.s. caktohen në gjykatë apelit. Në momentin që u mbaron mandati si anëtarë të Gjykatës së Lartë, iu mbaron dhe statusi, ata nuk kanë më asnjë arsye pse të quhen me status magjistrati. Kjo ishte arsyeja pse votova pro variantit të parë. Faleminderit!

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi, të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, zotit {...}, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivelin e gjykatës së apelit. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

Këshilli vendosi, të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtaren... I kalojmë në votim një nga një.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord për mbarimin e statusit, gjithmonë për arsyen. U tha një herë, që s'po e përsëris për të tjerët.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi, të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, zotin {...}, për shkak të dorëheqjes nga e drejta e caktimit në një pozicion të nivelit të gjykatës së apelit. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë. Kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

*(Vota e zotit Bici nuk është regjistruar për shkak se nuk ka pasur të ndezur mikrofonin. Edhe zoti Bici është pro.)*

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi, të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, {...}, për shkak të dorëheqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të nivelit të gjykatës së apelit. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi, të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë zonjën {...}, për shkak të dorëheqjes nga e drejta në një pozicion në nivel gjykate apeli. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Këshilli vendosi, të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, zonjën {...}, për shkak të dorëheqjes nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Abstenoj, për pengesë ligjore.

*(Anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonat, që nuk lejohet.)*

**Naureda Llagami:** Duhet t'ia sillje Kryetares pengesën.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 24.04.2019)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 13:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Marjana Papa, OSCE.*
6. *Sindi Liço, Qendra Evropiane.*
7. *Migena Kondo, KSHH.*
8. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Erjon Fejzulla, USAID.*
11. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
12. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun”.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë tek çështja e fundit e rendit të ditës, që unë në fakt jam shumë e lumtur që do e diskutojmë këtë çështje. Këshilli është treguar, për herë të parë, shumë bashkëpunues, për të propozuar një anëtar i cili midis nesh...

Jo, nuk do e bëjmë me short, se nuk më pëlqen shorti në rastin konkret.

Atëherë, çështja e fundit e rendit të ditës lidhet me përcaktimin e një anëtari për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.

Siç jeni në dijeni, detyrimet ligjore, neni 91 i ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” mbart detyrimin që Këshilli duhet të caktojë një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun. Ndaj, duke vlerësuar të rëndësishme marrëdhëniet e KLGJ-së, të institucionit të ri me publikun, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e këtyre marrëdhënieve në vijimësi, Këshilli, mbart

detyrimin të caktojë një ndër anëtarët. Caktimi i një anëtari, përmbushja e detyrave nga ana e tij, do të jetë një hap shumë i rëndësishëm në hapjen e informacionit, krijimin e raporteve dhe përmirësimin e aksesit në informacion për Këshillin dhe për të gjithë sistemin.

Duke qenë se Kryetarja, gjatë gjithë kësaj periudhe katër mujore të punës së saj, ka vlerësuar në mënyrë të pavarur të gjithë anëtarët e Këshillit dhe si e kanë qasjen ato ndaj publikut dhe marrëdhënien ndaj medias dhe publikut, ka një propozim konkret. Propozimi konsiston që, si anëtar nga Këshilli, që do të jetë përgjegjës për këtë çështje, Kryetarja propozon zotin Erjon Muharremaj. Për këtë arsye, unë kërkoj mbështetjen tuaj për ta miratuar zotin Erjon Muharremaj në këtë lloj përgjegjësie të re.

Keni ndonjë sugjerim tjetër?

Po e hedhim në votim propozimin e bërë nga Kryetarja e Këshillit Gjyqësor, lidhur me caktimin e zotit Erjon Muharremaj për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Ju falënderoj për mbështetjen.

Zoti Erjon Muharremaj, përgëzime për detyrën e re.

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit shumë.

**Naureda Llagami:** Ju faleminderit!



Lidhur me mbledhjen e radhës, nuk e di nëse kemi parashikuar për të premtën ndonjë mbledhje? Si jemi me çështjen e projekt-akteve? Okej. Dakord.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**